

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5963
E mërkurë, 26 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Porosia e Imzot Dodë Gjergjit për Krishtlindje 2019



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

Flet për 'Epokën e re', Ramush Haradinaj

FAQE 4-5



KOSOVA NË MANDATIN TIM U BË FUNKSIONALE

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se me qeverisjen e tij ia ka lehtësuar shumë punën pasardhësit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", e cila do të botohet e plotë në numrin festiv, ai ka thënë se për këto dy vjet e ka ndryshuar Kosovën për të mirë. Haradinaj ka thënë se Albin Kurti mund të flasë tash çfarë të dojë, sepse gjatë këtij mandati si kryeministër e ka bërë Kosovën funksionale. "Kosova ka ndryshuar fort për dy vjet të qeverisjes sime", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se për dy vjet të qeverisjes së tij ka prishur shumë plane të këqija dhe ka bërë shumë armiq. Ai ka thënë se vonesat për krijimin e qeverisë së re nuk sjellin ndonjë problem në Kosovë. Në këtë intervistë të gjatë Haradinaj ka folur për vendimet e veta më të vështira gjatë këtij viti, për raportet me ndërkombëtarët dhe për përplasjen me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama

Akademia e Shkencave kundërshton minishengenin ballkanik

FAQE 5



Seanca konstituive nesër, LV-ja dhe LDK-ja ende pa marrëveshje

Kuvendi i Kosovës ka njoftuar se këtë të enjte në orën 15:00 do të mbahet seanca konstituive në të cilën janë tri pika të rendit të ditës: Formimi i komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve, dhënia e betimit të



deputetëve dhe zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe e nënkryetarëve. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk kanë arritur marrëveshje për koalicionin qeverisës, ndonëse kanë mbetur edhe dy ditë nga mbajtja e seancës konstituive



OPINION

ARTI I VËSHTIRË I TË JETUARIT NË PAQE F. 12



Bedri ISLAMI

AKTUALE

LIDERËT UROJNË PËR KRISHTLINDJE F. 8

MATOSHI: VITI 2019, VIT I SFIDAVE DHE SUKSESEVE NË FUSHËN E MJEDISIT F. 8

EKONOMI

IMPORTI I MALLRAVE NË KOSOVË KAP VLERËN 297,6 MILIONË EURO F. 9

TAKSA RRTI VETËBESIMIN NË PRODHIM F. 9

KULTURË

FETAHU: VITI 2019, I JASHTËZAKONSHËM PËR BASKETBOLLIN F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878


SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqët tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përfutur nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.

Zaevi: Zgjedhjet mund të shtyhen



SHKUP, 24 DHJETOR - Kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, deklaroi se zgjedhjet e caktuara të mbahen në 12 prill mund të shtyhen. Ai tha se Kuvendi mund të mos shpërbëhet në mesin e shkurtit në rast se nuk miraton paraprakisht ligjet që janë në dobi të qytetarëve. "Ligjet thelbësore, mosmiratimi i të

cilave pengon pensionet, sigurimet shoqërore, rritjen e pagave, gjithë atë që nënkupton jetë për qytetarët, atëherë zgjedhjet edhe mund të shtyhen. Nuk e them këtë sot si kërcënim, sepse përgjegjësia e çdo deputeti pavarësisht nga pushteti apo opozita është përgjegjësi edhe e Qeverisë, pushtetit lokal dhe gjithë të

tjerëve që e marrin rrogën nga qytetarët. Unë nuk e dëshiroj shtyrjen e zgjedhjeve, e kam përsëritur pafund se zgjedhjet nuk duhet të shtyhen por njëkohësisht detyrimi i parë janë qytetarët. Detyrimi i dytë edhe politik është që të mos lejojmë të frenohet interesi i qytetarëve, kjo është më e rëndësishmja", është shprehur

Zaev.

Në Maqedoninë e Veriut është vendosur që diskutimi publik për ndryshimin e Kodit Zgjedhor të organizohet jashtë institucionit ligjvënës. Propozimi për një njësi zgjedhore kundërshtohet nga dy partitë më të mëdha parlamentare BDI dhe VMRO me 6 mijë amendamente.

Institucionet shtetërore kanë rol kyç për reformimin e sektorit të edukimit në vend

Në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku u diskutua për rezultatet alarmuese të vendit në testin e fundit të Programit PISA, u tha se kjo duhet të shërbejë si pikë referimi për institucionet shtetërore për rishikimin e sistemit arsimor në vend

**EPOKA ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Rezultatet e testit PISA duhet të shërbejnë si pikë referimi për institucionet shtetërore për rishikimin e sistemit arsimor në vend. Kjo u tha të martën gjatë një tryeze të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në të cilën u diskutua për rezultatet alarmuese të vendit në testin e fundit të Programit për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve PISA dhe ndikimit të tyre në sektorin privat.

Besnik Krasniqi, hulumtues i

çështjeve ekonomike dhe profesor universitar, tha se rezultatet e testit PISA nuk janë aspak befasuere duke e marrë parasysh se zhvillimi i programeve dhe i metodologjisë së mësimdhënies në Kosovë nuk i aftëson nxënësit për ta aplikuar dijen praktike në kontekst specifik. Ai shtoi se zhvillimi joadekuat i aftësive kreative të nxënësit ka implikime edhe në sektorin privat, i cili në anën tjetër nuk mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit pa një rol proaktiv të institucioneve shtetërore për dialogun në këtë aspekt.

Gresa Statovci, konsulente e arsimit, tha se, shikuar nga këndvështrimi ekonomik, përmirësimi i cilësisë së arsimit është parametri kryesor për zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Ajo shtoi se në kuadër të përpjekjeve për përmirësim e gjendjes së sistemit arsimor, Kosova është duke e implementuar kornizën e kurrikulës së re të arsimit, e cila me përmirësime adekuate do të sillte rezultate më të mira në testin PISA dhe, rrjedhimisht, një fuqi punëtore më të përgatitur.

Statovci theksoi se është e domosdoshme që në hartimin e

politikave të arsimit të përfshihet edhe sektori privat në mënyrë që të zvogëlohet hendeku ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Në anën tjetër, psikologu si dhe profesori universitar, Naim Telaku, nga aspekti psikologjik i elaboroi disa faktorë të cilët mund të kenë ndikuar në rezultate të dobëta në testin e PISA-s, siç janë kurrikula e papërshtatshme, përdorimi jo i duhur i teknologjisë, vështirësitë emocionale dhe mosfunksionimi i trekëndëshit prind-fëmijë-mësimdhënës. Ai ka pohuar se shpeshherë roli i

mësimdhënësve dhe qasja e tyre si autoritet i pakontestueshëm rezultojnë në demotivim të nxënësve, të cilët në të njëjtën kohë hasin një presion të vazhdueshëm nga prindërit e tyre për rezultate më të mira.

Telaku bëri thirrje për zbatim të të gjitha udhëzimeve të nevojshme nga programi PISA për përmirësimin e sistemit të arsimit, duke integruar këtu edhe ndihmën e sektorit privat. Telaku, mes të tjerash, foli edhe për nevojën e një qasje që kombinon në inteligjencën emocionale me zhvillimin e aftësive kognitive.

Vulin: Serbia do të zhvillojë ushtrime ushtarake me Kinën

BEOGRAD, 24 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Aleksandar Vulin, tha se Serbia nuk do të anëtarësohet në NATO derisa presidenti Aleksandar Vučić dhe kjo shumicë parlamentare të jenë në krye të vendit. Ai paralajmëroi se Serbia, për herë të parë, do të zhvillojë ushtrime ushtarake me Kinën, gjatë vitit të ardhshëm. "Ne po bashkëpunojmë me NATO-n,

por gjithashtu jemi duke bashkëpunuar me vendet e ish-Bashkimit Sovjetik në kuadër të Traktatit të Sigurisë Kolektive. Këto vende nuk na kërkojnë të heqim dorë nga një pjesë e territorit", tha Vulin në Parlamentin serb. Ai tha se neutraliteti ushtarak është "i shtrenjtë", por që nuk ekziston presion nga i cili do të hiqte dorë nga kjo politikë, sepse shtoi ai "ju nuk jeni një

vend i lirë nëse dikush tjetër ju ruan qiellin".

Serbia ka zhvilluar stërvitje ushtarake me Rusinë gjatë muajit tetor.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, kishte deklaruar se është i impresionuar nga ajo që mund të bëjnë sistemet ruse tokë-ajër. Serbia, e cila është bombarduar nga NATO-ja në vitin 1999 për shkak të dhunës në Kosovë, e

kundërshton anëtarësimin në aleancë.

Rusia po ashtu është kundër zgjerimit të NATO-s me vendet e Ballkanit.

Në muajin nëntor, Departamenti amerikan i Mbrojtjes ka nxjerrë një dokument, në të cilin thuhet se marrëdhëniet Serbi-Rusi janë forcuar që nga ardhja në pushtet e Vuçiqit në vitin 2012.



Nesër seanca konstituive, LV-ja dhe LDK-ja ende pa marrëveshje



Kuvendi i Kosovës ka njoftuar se këtë të enjte në orën 15:00 do të mbahet seanca konstitutive, në të cilën janë tri pika të rendit të ditës: Formimi i komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve, dhënia e betimit të deputetëve dhe zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk kanë arritur marrëveshje për koalicionin qeverisës, ndonëse kanë mbetur edhe dy ditë nga mbajtja e seancës konstituive

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka dërguar njoftim zyrtar për mbajtjen e seancës konstitutive këtë të enjte, në orën 15:00. Nga zyra për media e Kuvendit është bërë me dije se në rend të ditës janë tri pika. "1. Formimi i komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve; 2. Dhënia e betimit të deputetëve; dhe 3. Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit", është thënë në njoftimin për media të Kuvendit të Kosovës.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk kanë arritur ende marrëveshje për koalicionin qeverisës, ndonëse kanë mbetur edhe dy ditë nga mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk janë takuar as të martën për të biseduar për këtë çështje, ndërsa zyrtarët e këtyre partive kanë polemizuar në distancë.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë të martën se është i gatshëm të takohet me liderin e LV-

së, Albin Kurti. Pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së, Mustafa ka deklaruar se po e pret thirrjen e Albin Kurtit për takim.

Ndërkaq deputetja e LV-së, Arbërie Nagavci, ka thënë të martën se pret nga përfaqësuesit e LDK-së që do t'i hapin udhë krijimit të institucioneve. Ajo shpreson se marrëveshja LV-LDK do të arrihet para konstituimit të Kuvendit. "Qeveria LV-LDK do të ketë shumë punë para vetes. Na është dhënë besimi e qytetarët presin të fillojë sa më parë jetësimi i programit për të cilin jemi pajtuar tashmë bashkë. Shpresoj shumë që të arrihet marrëveshja para konstituimit të Kuvendit. Pres që përfaqësuesit e LDK-së dhe deputetët që kanë marrë përgjegjësi nga qytetarët, të jenë aktivistë të vërtetë politikë, të tillë që pozitën e deputetit e shohin si përgjegjësi, si mundësi për të punuar për të mirën e përgjithshme dhe se me votim të qeverisë do ta fillojnë punën për realizimin e përgjegjësive për besimin që kanë marrë. Na nevojitet një qeveri e ndryshimit që bazohet në mirëbesim e bashkëpunim konstruktiv", ka thënë Nagavci.

KDI-ja kërkon formimin e institucioneve të reja

"Tanimë kur kanë kaluar katër muaj që nga shpërndarja e legjislaturës së VI të Kuvendit të Kosovës, dhe një muaj që nga certifikimi i rezultateve zgjedhore, vendi po vazhdon të qeveriset nga qeveria në dorëheqje dhe pa mbikëqyrje të Kuvendit.

Kjo gjendje është duke cenuar parimin e kontrollit dhe balancës të pushteteve", është thënë në komunikatën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI)

Sipas KDI-së, thirrja e seancës konstituive për datën 26 dhjetor është hapi i parë formal drejt krijimit të institucioneve të reja, respektivisht konstituimit të Kuvendit dhe formimit të Qeverisë së Kosovës.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) vlerëson që subjektet politike parlamentare kanë pasur kohë të mjaftueshme për të arritur pajtueshmëri për propozimet për kryetar dhe pesë nënkryetarët e Kuvendit, për votimin e të cilëve kërkohen të paktën 61 vota për. "KDI-ja u bënë thirrje subjekteve politike

parlamentare që në përputhje me Kushtetutën dhe vullnetin e qytetarëve të tregojnë përgjegjësi dhe konstruktivitet për arritjen e konsensusit për formimin e institucioneve të reja. Çdo sjellje politike irracionale dhe bllokuese do ta pengojë konstituimin e institucioneve shtetërore dhe do t'i minojë pritjet e qytetarëve për zhvillim ekonomik, sundim të ligjit, mirëqenie e jetë të dinjitetshme. KDI-ja rikujton që Qeverinë e re të Kosovës e presin çështje që kërkojnë trajtim të menjëhershëm siç janë miratimi i buxhetit për vitin e ardhshëm fiskal, implementimi i reformave që derivojnë nga MSA-ja, si dhe emërimi i anëtarëve të institucioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Tre skenarët e seancës konstituive të Kuvendit

Njohësi i proceseve politike në vend, Artan Murati, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar për tre skenarët e seancës konstituive të Kuvendit më 26 dhjetor. Ai ka thënë se skenari i parë është më i mirë nëse arrihet marrëveshja, ndërsa nëse mbetet që institucionet të formohen me skenarin e dytë dhe të tretë, atëherë fillojnë telashet. "Skenari i parë, më i miri: arrihet marrëveshja e koalicionit. Zgjedhja e kryetarit dhe e kryesisë bëhet shpejt dhe

thjesht. Deputetët betohen, konstituimi kryhet. I dyti: nuk ka marrëveshje. LV-ja e propozon kandidatin për kryetar Kuvendi. Nëse votohet, mirë. Nëse nuk votohet, fillojnë telashet. Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk parasheh çka ndodhë nëse votimi është negativ. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se propozimin për kryetar të Kuvendit e mban ekskluzivisht grupi më i madh parlamentar, që i bie Lëvizja Vetëvendosje. Nëse nuk kalon i pari, duhet

konsensus për emrin e propozimit tjetër të LV-së. I treti, më i keqi: meqenëse nuk ka afat për konstituim të Kuvendit, dhe meqenëse veç LV-ja e ka të drejtën për propozim të emrit për kryeparlamentar, seanca mund të bllokohet. LV nuk paraqet propozim, ose nuk merr pjesë në seancën konstituive. Këtu fillojnë lojërat e tjera politike. Shpresoj që do të ndodhë skenari i parë. Nuk kemi kohë për të humbur, as edhe një ditë të vetme", ka shkruar Murati.

Flet për "Epokën e re", Ramush Haradinaj

Kosova në mandatin tim u bë



Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se me qeverisjen e tij ia ka lehtësuar shumë punën pasardhësit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", e cila do të botohet e plotë në numrin festiv, ai ka thënë se për këto dy vjet e ka ndryshuar Kosovën për të mirë. Haradinaj ka thënë se Albin Kurti mund të flasë tash çfarë të dojë, sepse gjatë këtij mandati si kryeministër e ka bërë Kosovën funksionale. "Kosova ka ndryshuar fort për dy vjet të qeverisjes sime", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se për dy vjet të qeverisjes së tij ka prishur shumë plane të këqija dhe ka bërë shumë armiq. Ai ka thënë se vonesat për krijimin e qeverisë së re nuk sjellin ndonjë problem në Kosovë. Në këtë intervistë të gjatë Haradinaj ka folur për vendimet e veta më të vështira gjatë këtij viti, për raportet me ndërkombëtarët dhe për përplasjen me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se me qeverisjen e tij ka ndryshuar Kosovën. Ai ka thënë se me punën që ka bërë gjatë këtij mandati ia ka lehtësuar punën pasardhësit, Albin Kurtit. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", e cila do të botohet e plotë në numrin festiv të gazetës, Haradinaj ka thënë se e ka bërë Kosovën shtet funksional. "Sot Kosova është tjetër vend. Kur kam qenë unë mandatar para dy vjetësh ka qenë problematike gjendja në vend, si rendi, ligji, siguria në veri dhe shumë probleme të tjera. Tash Albin Kurti e ka livadh, le të flasë çfarë të dojë, sepse Kosova është funksionale. Vonesat për krijimin e qeverisë së

re nuk sjellin ndonjë problem në Kosovë. Natyrisht se është mirë që sa më shpejt ta bëjë qeverinë e re, por kështu nuk ka qenë kur e kam marrë unë mandatin. Kosova ka ndryshuar fort për dy vjet të qeverisjes sime", ka thënë Haradinaj. Ai ka vlerësuar se pasardhësi i tij do ta ketë më të lehtë që të merret me çështje të tjera. "Ju po e shihni edhe vetë. A ka ndonjë shqetësim në Kosovë? Çdo gjë është funksionale në këtë vend, si në jug e veri, ashtu edhe në lindje e perëndim. Ai të dalë e të thotë çfarë të dojë publikisht. Merret me Sanxhakun, me Maqedoninë, me Tiranën, mos të flasim për të tjerat. Ka nge kryeministri i ardhshëm, i cili do të vijë dhe do të merret me shëndetësi, arsim dhe me i ndalë harxhimet e paarsyeshme e me çkap shtetin qysh po thotë. Por, prapëseprapë Kosova po funksionon", është

shprehur Haradinaj. Shefi i qeverisë ka vlerësuar se funksionaliteti i shtetit të Kosovës është dëshmuar edhe në ditën e zgjedhjeve, duke shtuar se institucionet e Republikës së Kosovës kanë treguar integritet të lartë më 6 tetor duke mos lënduar vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Ai ka thënë se gjatë gjithë mandatit ka respektuar opozitën. "Opozita është trajtuar me respekt gjatë gjithë kohës së qeverisjes time. Asnjë diskriminim apo ndëshkim nuk iu ka bërë opozitës në këtë mandat. Përkundrazi, e kemi respektuar gjatë gjithë mandatit. E kemi respektuar ditën e zgjedhjeve dhe kemi respektuar rezultatin. Kjo është Kosova që e kemi krijuar bashkë. Kjo është meritë e pozitës dhe opozitës. Pra, është meritë edhe e pozitës e cila ka ditë të sillet asisoj që t'i japë hapësirë opozitës që të vijë deri te fitoja. Ka

funksionale

kryer mision në shërbim të shumicës. AAK-ja sot nuk është shumicë, por ka kryer punë në funksion të shumicës për qindra vjet", ka thënë ai, duke shtuar se nuk ka punuar si kryeministër për ta përvetësuar shumicën, por për të kryer punë në shërbim të vendit. "Unë kam punuar për të kryer punë dhe nuk kam punuar për ta përvetësuar qytetarin me votë. Kam punuar që t'ia lë do punë qytetarit tim në themel, të cilat nuk mund t'ia marrë askush. Asnjë resurs i Kosovës nuk është sot i kontestuar prej ndonjë vendi tjetër ose prej dikujt që pretendon se ka hise në Kosovë. Ushtria, energjia dhe taksa, këto janë punët që ne i kemi bërë", ka vlerësuar Haradinaj.

Ndër të tjera, Haradinaj ka folur edhe për përplasjet me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ai ka thënë se i vjen keq prej shqiptarëve që kryeministrat e këtyre dy vendeve po polemizojnë në distancë. I pari i qeverisë ka sqaruar se kur pozicionohet për çështje nacionale nuk e bën këtë për inat apo për hatër të dikujt tjetër. "Krejt shqiptarët, pavarësisht feve, krahinave, partive politike, jemi vëllezër e motra. Ne jemi një. Por, për interesa nacionale nuk kam qare pa u pozicionuar. Dhe kur pozicionohem nuk e bëj për inat të njërit apo për hatër të njërit, sepse për interes nacional janë vrrarë Shkëlzeni, Luani dhe familja ime i ka kaluar ato që i ka përjetuar. Kur kam dalë kundër ndarjes dhe kundër asaj se 'Trepça' t'i mbetet Serbisë nuk mërzhitem se kush hidhërohet. Aty është burimi i ndasive që kemi. U kërkujmë falje të gjithë shqiptarëve që i mërzhisim tash me këtë gjuhë që përdoret", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri në detyrë i Kosovës ka kritikuar Qeverinë e Shqipërisë që i ka sjellë pengesa dy ekonomive në momentin që Kosova ka vendosur taksën prej 100 përqindësh për produktet serbe. Ai ka vlerësuar se Shqipëria është dashur ta marrë tregun e Kosovës dhe jo të vendosë taksë. "Me dhimben shqiptarët e Shqipërisë, vëllezërit e motrat e jugut, sepse ne kur i kemi vendosur taksë Serbisë është dashur që Shqipëria ta fitojë tregun në Kosovë. Kur Kosova iu heq si treg Serbisë, në vend se Shqipëria ta marrë këtë treg, shqiptarët mes vete kanë vendosur taksë në rrugë, e cila është 42 euro për kamion e 5 euro për makinë. Pra, ne kemi vendosur bllokadë që mos me u lidh këto ekonomit", ka thënë Haradinaj.

Në këtë intervistë Haradinaj ka folur për vendimet e veta më të vështira gjatë këtij viti, për raportet me ndërkombëtarët, për liberalizimin e vizave, për taksën dhe për partnerët e koalicionit.

vende të tjera që nuk e lejojnë opozitën të vijë deri te fitorja. Ne i shohim këto në të dyja anët e Kosovës. Këtu nuk e ka penguar dikush opozitën për të fituar, për t'u rritur dhe që të ndihet e lirë", është shprehur Haradinaj. Në këtë intervistë i pari i AAK-së ka folur edhe për rezultatin jo të mirë të kësaj partie në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka treguar se pse pushteti këtij subjekti politik nuk i ndihmojë ta rritë votën qytetare. "Kam prishur shumë plane dhe kam bërë shumë armiq gjatë dy vjetëve të qeverisjes sime. Kemi dalë kundër shumë erërave të fuqishme. Unë nuk jam shumica sot, por kam bërë punë për shumicën. Nuk kam qenë as në kohën e luftës për liri shumicë, por kemi bërë punë për shumicën. E vërtetë është ajo që thotë Surroi, se UÇK-ja nuk ka qenë shumicë. Por, si pakicë kam

Akademia e Shkencave kundërshton minishengenin ballkanik

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) ka theksuar se minishengeni ballkanik nuk është i mundur në një asimetri të këllë politike në Ballkan, me dominim të theksuar të Serbisë, duke qenë se ajo nuk njeh Kosovën dhe që çdo ditë minon dhe shantazhon përparimin e saj, synon ndarjen dhe copëtimin e saj, mohon krimet dhe nuk respekton marrëveshjet e arritura dhe që është e angazhuar gjerësisht në pengimin e integriteteve të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINE, 24 DHJETOR - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) ka kundërshtuar idenë e proklamuar në tre samitet për minishengenin ballkanik, sidomos në atë të Tiranës. ASHAK-u në reagimin e vet ka thënë se minishengeni nuk është i mundur në një asimetri të këllë politike në Ballkan, me dominim të theksuar të Serbisë, duke qenë se ajo nuk njeh Kosovën dhe që çdo ditë minon dhe shantazhon përparimin e saj. "Të përballur me kriza të brendshme dhe me dështime të njëpasnjëshme në çështje të reformave dhe të integriteteve evropiane; me rritjen e vazhdueshme të autoritarizmit dhe të pushtetit të pakontrolluar të oligarkëve; me cenimin e pashembull të lirisë së shprehjes dhe të veprimtimit opozitar; me përfshirjen e pandalur të të gjithë pushteteve në një paqëndrueshmëri institucionale, tre shtete fqinjë të

Kosovës (Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria) së fundi bënë një depërtim medial në opinionin tonë me një marrëveshje që duhej t'i imitonte punët e rëndësishme të Evropës, me të ashtuquajturin minishengen ballkanik, duke prodhuar të vetmin efekt të dukshëm dhe të prekshëm: çrregullimin serioz të marrëdhënieve Kosovë - Shqipëri dhe lëndimin e krejt ndjeshmërisë sonë rreth këtyre marrëdhënieve. Duke e parë këtë rrethanë dhe duke vërejtur dëmin e konsiderueshëm që shkaktoi kjo nismë në politikëbërjen shqiptare, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) është e shtrënguar të reagojë, duke konsideruar se nisma e propozuar nga Serbia ka prapavijë të qartë subversive dhe synon rrënimin e perspektivës evropiane të rajonit të Ballkanit, duke krijuar alternativa minuese dhe defaktorizim të potencialit politik shqiptar në këtë proces", është thënë në reagimin e ASHAK-ut. Më tej në këtë reagim të ASHAK-ut

thuhet se duke e ditur se Kosova nuk mund të përfshihet në asnjë proces dhe në asnjë marrëveshje ku ajo nuk është e barabartë dhe ku asaj nuk i njihet shtetësia dhe sovraniteti, fyerja dhe lëndimi që iu bë asaj në takimin e fundit në Tiranë, përfshirë edhe tiradat përcmuese të kryeministrit të Shqipërisë, kap përmasat e një hakmarrjeje të paarsyeshme dhe me konotacion të frikshëm për të ardhmen e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. "ASHAK-u fuqimisht mbështet qëndrimin se minishengeni ballkanik nuk është i mundur në një asimetri të këllë politike në Ballkan, me dominim të theksuar të Serbisë, duke qenë se ajo nuk njeh Kosovën dhe që çdo ditë minon dhe shantazhon progresin e saj, synon ndarjen dhe copëtimin e saj, mohon krimet dhe nuk respekton marrëveshjet e arritura dhe që është e angazhuar gjerësisht në pengimin e integriteteve të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë dhe duke ndërmarrë sulme të vazhdueshme diplomatike për ta zvogëluar numrin e njohjeve. Mbi të gjitha, Kosova nuk mund të përfshihet në një proces të udhëhequr nga Serbia, përderisa ajo vazhdon ta mbajë Kosovën në Kushtetutën e saj si pjesë e këtij shteti dhe aq më pak të përfshihet në aleanca që shkojnë kundër interesave tona kombëtare dhe krijojnë alternativa të kundërvënies ndaj integriteteve evropiane dhe euroatlantike", është theksuar në reagimin e ASHAK-ut.



Në Spitalin e Vushtrrisë për herë të parë fillon punën salla operative e urologjisë

VUSHTRRI, 24 DHJETOR (ER) - Në Spitalin e Përgjithshëm "Sheikh Zayed" në Vushtri ka nisur punën salla operative e urologjisë. Funkcionalizimi i sallës operative të urologjisë erdhi si rezultat i investimit nga "Gjysmëhëna e Kuqe", investimeve vetjake të Spitalit "Sheikh Zayed" dhe Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Uretrocistoscopia u realizua nga specialisti i urologjisë pranë Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtri, dr. Skender Hoxha, dhe instrumentarja Valbona Pllana.

Menaxhmenti i Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtri, mbështetur edhe nga ShSKUK-ja,

do t'i nisë shërbimet operative urologjike në tërësi, të cilat do të mbikëqyren dhe organizohen nga specialistët urologë dr. Skender Hoxha dhe dr. Jeton Islamaj. Fillimisht, në sallën operative të urologjisë u realizua uretrocistoscopia, si metodë diagnostike, përmes së cilës mund të konstatohen ndryshimet në traktin e poshtëm urinar. Përmes kësaj metode, e cila ka nisur që nga sot të aplikohet në Spitalin "Sheikh Zayed", mund të diagnostikohen me kohë tumoret e fshikëzës urinare, ngushticat e uretrës, gurët në fshikëz dhe sëmundje të tjera.



Kryeprokurori i Pejës diskutoi për planin e punës për vitin 2020 me shoqërinë civile dhe mediat

PEJË, 24 DHJETOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj, ka mbajtur takim me përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe të mediave. Gjatë takimit të sotëm është diskutuar për objektivat e planit të punës së kësaj prokurorie për vitin 2020, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe mediave kanë pasur mundësi të rekomandojnë propozime të ndryshme para hartimit të planit të punës për vitin e ardhshëm nga Prokuroria Themelore e Pejës.

Të pranishmit vlerësuan se diskutimet e tilla janë të mirëseardhura dhe janë në interes të përgjithshëm për luftimin e dukurive negative që janë nën kompe-



tencën ligjore dhe territoriale të Prokurorisë Themelore të Pejës. Kryeprokurori Kurmehaj falënderoi të pranishmit për kontributin e tyre, njëkohësisht u zotua se rekomandimet e marra gjatë këtij takimi do të shqyrtohen për përfshirjen e tyre si pjesë e planit të punës, i cili do të hartohet nga kjo prokurori.



25 biznese marrin pjesë në Panairin e Turizmit në Prizren

PRIZREN, 24 DHJETOR (ER) - Në hapësirat e Kejit, përballë xhamisë së Sinan Pashës, është organizuar Panairi i Turizmit, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 25 biznese, shoqata dhe operatorë turistikë të ndryshëm që merren me fushën e turizmit. Panairi është hapur nga kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher

Haskuka, ndërsa mysafirë ishin edhe përfaqësues nga komunat e tjera si ajo e Ulqinit, e Pejës dhe Kusadasi i Turqisë. Në kuadër të këtij panairi është organizuar edhe ekspozita e fotografive të vjetra të qytetit të Prizrenit "Prizreni dikur dhe sot", si dhe konferenca "Gastronomia dhe turizmi".

Bahtiri mbajti tubimin e dytë publik me qytetarë për vitin 2019

MITROVICË, 24 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur të martën tubimin e dytë publik me qytetarë për këtë vit, në të cilin është diskutuar rreth punës së ekzekutivit të komunës përgjatë vitit 2019. Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile si dhe një pjesëmarrje e kënaqshme e qytetarëve.

Pasi ka falënderuar qytetarët për pjesëmarrje, kryetari Bahtiri ka thënë se qëllimi i këtij takimi është që qytetarët të njoftohen për punët që po bëhen në Komunën e Mitrovicës, për problemet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen në punën e përditshme, si dhe që qytetarët t'i japin vërejtjet e tyre dhe të parashtrajnë kërkesa, të cilat, nëse janë të arsyeshme dhe të pranueshme, gjithsesi se do të realizohen.

Në vazhdim, Bahtiri i ka njoftuar pjesëmarrësit me punët që janë bërë përgjatë këtij viti, duke thënë se gjatë këtij viti



është punuar me shumë përkushtim për përmbushjen e kërkesave dhe të nevojave të qytetarëve, për krijimin e klimës dhe ambientit për investime, për realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore, për mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimit në bujqësi, për kursimin e mjeteve nga mallrat dhe shpenzimet.

Të pranishmit i kanë shtruar pyetje dhe i kanë dhënë sugjerime ekzekutivit për punën njëvjeçare, ndërsa drejtorët e drejtorive u kanë dhënë përgjigje të gjithë atyre që kanë drejtuar pyetje për projektet që janë realizuar gjatë këtij viti.

Lladrovci shpalos para qytetarëve punën njëvjeçare

DRENAS, 24 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka mbajtur tubimin e dytë me qytetarët, ku ka raportuar për punën njëvjeçare. Në tubim kanë marrë pjesë drejtorë të drejtorive komunale, administratorë të fshatrave, përfaqësues të OJQ-ve

lokale, OSBE-ja dhe qytetarë. Lladrovci i ka falënderuar qytetarët të cilët iu përgjigjen ftesës së tij për t'i identifikuar së bashku lëshimet në projektet që realizohen në Komunën e Drenasit. "Uroj që edhe në vitin 2020 të kontribuoni edhe denonconi çdo lëshim gjatë

kryerjes së punëve, duke denoncuar me fakte", ka thënë Lladrovci. Ai ka bërë me dije se të gjitha projektet e parapara do të kryhen gjatë vitit 2019, madje edhe shumë projekte të bashkëfinancuara me nivelin qendror kanë përfunduar sipas planifikimit.



Matoshi: Viti 2019, vit i sfidave dhe sukseseve në fushën e mjedisit



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka mbajtur të martën konferencën për media, të fundit për këtë vit, në të cilën ka paraqitur projektet dhe aktivitetet që janë zhvilluar brenda këtij viti.

Ministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, ka përmendur veprimet e ministritë, hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, investimet milionëshe në fushën e mjedisit dhe të planifikimit hapësinor,

përkrahjen për komunat, bashkëpunimin me donatorët si dhe sfidat për të ardhmen.

Sipas Matoshit, prioritet i tij kryesor gjatë mandatit qeverisës ka qenë mbrojtja e burimeve ujore si dhe ndërtimi i hidrosistemeve të reja në Kosovë, në mënyrë që të sigurohet ujë i pijshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. "Për këtë bashkë me Bankën Botërore, pas një pune njëvjeçare, kemi arritur që të fillojmë së jetësuar projektin më të madh në këtë fushë, ndërtimin e hidrosistemit KIK-Kremenatë, i cili do t'i evitojë krizat që kemi për

sigurimin e ujit të pijshëm në pjesën lindore të Kosovës. Projekte të tilla do të realizohen edhe në komuna të tjera të Kosovës", ka thënë Matoshi.

Ai ka theksuar se me buxhetin e MMPH-së janë duke u realizuar shumë projekte për rregullimin e shtretërve të lumenjve në të gjitha komunat e Kosovës, për ta eliminuar degradimin e madh, e të cilat arrijnë vlerën rreth 16 milionë euro. "Për momentin në vendin tonë trajtohen vetëm 4 për qind e ujërave të zeza. Në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë kemi filluar

projektet për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, disa prej të cilave janë në përfundim e sipër e disa të tjera në fazën fillestare të realizimit", është shprehur Matoshi.

Ai ka folur edhe për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave duke thënë se MMPH së bashku me shoqërinë civile kanë organizuar fushata pastrimi dhe rehabilitimi të zonave të degraduara me vite në Kosovë përmes krijimit të zonave të reja të gjelbra. "Kemi filluar investimet në zonat e veçanta të mbrojtura në Kosovë, në të cilat me vite nuk ka pasur kushte të përshtatshme minimale për vizitorë, duke përfshirë Ujëvarën e Mirushës, Shpellën e Gadimes etj. Po ashtu, kemi përkrahur komunat e Kosovës për ngritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ku bashkë me GIZ-in dhe BE-në kemi lansuar grantin e performancës për komunat me 7 milionë euro", ka thënë tutje ministri Matoshi.

Ai ka thënë se kanë marrë grant 2.2 milionë euro nga Qeveria e Japonisë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, kanë hartuar strategjinë për menaxhimin e mbeturinave si dhe janë duke u dhënë zgjidhje qeseve të plastikës dhe, po ashtu, janë në krijim e sipër të sistemit të kthimit të shisheve të plastikës, qelqit, kanaqeve. Matoshi ka deklaruar se inspektorati i MMPH-së gjatë këtij viti ka bërë 790 vizita inspektive në terren, ka shqiptuar qindra gjoba mandatore dhe 85 inicime ne gjykatë. "Ndotja e ajrit në kryeqytet dhe në disa komuna të tjera është një tjetër problem i madh i trashëguar dhe me të cilin jemi marrë brenda mandatit tim", është shprehur ministri Matoshi. Ai ka bërë me dije se në kuadër të Task Forcës Ndërmministrorë për Ajrin kanë adresuar çështje të rëndësishme bashkë me ministritë e tjera dhe donatorët kanë marrë veprime konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit.

Kryeministri vlerëson punën e zjarrfikësve

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, të kryesuar nga kryetari Muharrem Beka, për të pranuar nga ta shqetësimet dhe kërkesat e tyre. Me këtë rast kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka thënë se si qeveri kanë punuar shumë për rregullimin e statusit të zjarrfikësve, të lënë peng prej vitesh dhe se janë marrë vendime për përmbushjen e kërkesave që

kanë pasur, siç është ndarja e mjeteve prej 600 mijë eurosh për pagesën e orëve shtesë, puna në projektligjin e ri të Financave të Pushtetit Lokal dhe rregullimi i shumës së rrezikshmërisë.

Duke e çmuar lart punën e zjarrfikësve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka thënë se puna e tyre nuk do të shkojë pa u vërejtur. "Puna më e madhe për zjarrfikësit është bërë në Ligjin e ri për pagat, ku ata janë pozicionuar denjësisht me paga meritore, derisa tani do të punojmë për adresimin e të gjitha kërke-

save të tjera", ka thënë kryeministri në detyrë, Haradinaj.

Ndër të tjera, kryeministri në detyrë, Haradinaj, u shpreh se zjarrfikësit meritojnë respekt për punën e tyre në fushën e sigurisë dhe këtë respekt duhet ta adresojmë edhe përmirësimin e gjithë infrastrukturës ligjore, për ta rikthyer ashtu siç e meritojnë, në një forcë kombëtare. Zjarrfikësit e falënderuan kryeministrin në detyrë Haradinaj për përkushtimin e tij për t'i dëgjuar nga ta shqetësimet me të cilat përballen zjarrfikësit.



Ismaili nënshkruan kontratën për furnizim me barna për të prekurit nga skleroza multiple



PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije të martën se ka nënshkruar kontratën e parë për furnizim me barna për të prekurit nga skleroza multiple. "Kam nënshkruar kontratën e parë për furnizim me Interferon-Beta 1a, terapi për të prekurit nga skleroza multiple. Meqenëse kjo terapi nuk ka qenë më herët pjesë e listës esenciale, shumë familje koso-

vare të prekura nga kjo sëmundje e rrallë janë varfëruar si pasojë e shpenzimeve të larta. Nga sot ata nuk do të kenë nevojë që ta blejnë më atë, por do ta marrin falas në institucionet tona shëndetësore. Për më tepër, edhe terapia e ocrelizumab është në procedurë të blerjes. Shumë i lumtur me efektet e para të Listës së re të barnave esenciale", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Porosia e Imzot Dodë Gjergjit për Krishtlindje 2019

Të dashur vëllezër e motra, miq e dashamirë,

Është gjithnjë kënaqësi për mua të vij para jush për t'ju drejtuar porosinë time të fundvitit me rastin e festës së Kërshëndellave.

Këto ditë vërtet janë më të bukura sesa ditët e tjera gjatë vitit. Pasi gjithandej dëgjojmë këngë, shkëmbejmë dhurata, shijojmë me ëndje ndriçimin e shesheve dhe zbulimin e shtëpive tona. E gjithë kjo krijon një frymë festive, e cila shtrihet gjithkund gjatë muajit të dhjetorit, që ne e quajmë Koha e Ardhjes apo e Adventit. Edhe festa e Vitit të Ri që pason, i përafrojnë në këtë festë të gjithë njerëzit vullnetmirë dhe u mundëson atyre ta përjetojnë gëzimin e Kërshëndellave. Madje, disa edhe marrin pjesë aktive në kremtimin e kësaj feste.

Gjithë ky vështrim mbi festën e Krishtlindjes, i mbështetur në përmasat njerëzore, aq sa t'kapë syri, sa t'ndien veshi e sa t'merr mendja, nuk zgjat më shumë se deri në ditët e para të Vitit të Ri. Pastaj, fillon e venitet përsëri gjithçka: këngët e bukura të kërshëndellave nuk i dëgjojmë më nëpër qendrat tregtare, ndriçimi i shesheve hiqet e ne detyrohemi t'u kthehemi punëve të përditshme. Edhe nga ekranet televizive dhe mediat sociale hiqen këngët, vallet dhe humorit, e përsëri spikatin lajmet për grabitjet e shtëpive ose thyerjen e ndonjë kishe apo xhamie; për humbjen e jetëve gjithandej në aksidentet rrugore; për vetëvrasjet ose vrasjet e pakuptimita. Kurse, në familje ringjallen problemet e vjetra, të cilave iu shtohet trishtimi, kur shohin llogarit bankare ose kuletën e zbratur.

Talëmë mënjënjë përmasën njerëzore të përjetimit të Krishtlindjes e



t'i kthehemi përmasës mesianike të saj, që është përmasa e vërtetë e festës dhe e kremtimit të Kërshëndellave. Pastaj, te përvoja që na dhurohet gjatë kremtimit të kësaj feste, brenda bashkësisë së krishterë dhe në gjirin e Kishës; pra, te përmasa shpirtërore që ajo bart në vete.

Për besimtarin, Kërshëndellat janë festa e gëzimit të madh, për dashurinë që Hyji i ka dhuruar botës, duke mishëruar Fjalën e Amshueme në kraharorin e Virgjërës Mari. Që është ndërmarja më e madhe e Hyjit në përpjekjen e Tij të amshueshme për ta ripërtërirë veprën e vet më të përkryer, që jam unë e ti, vëlla dhe motër e dashur.

Kur ta besojmë këtë gjë, e kur të shohim se si Shpirti i Zotit, që na është dhuruar, na ka bërë më të dhimbshëm, më të mëshirshëm, më të butë, më bujarë, më besnikë, më të dashur, më paqedashës e më të përvuajtur, atëherë e falënderojmë Zotin për këto dhurata dhe kremtojmë me gëzim festën e Kërshëndellave. Kur këtë gëzim e bashkëndajmë me bashkësinë e të pagëzuarve, brenda Kishës, kremtimi i Kërshëndellave bëhet moment

vëllazërimi, paqeje dhe lumturie, që na forcon t'i përballojmë me dashuri e me duresë vështirësitë e përmendura më lart. Sepse, ne, në Krishtin, kemi gjetur udhërrëfyesin e shtegtimin tonë në botë, mësuesin e jetës, shpërblyesin e mëkateve tona, ndërmjetësuesin që na pajton me Atin Qiellor, shpëtimtarin e vërtetë, ngadhënjësin mbi vdekjen dhe Zotin e jetës. Kjo e bën të natyrshme lumturinë, gëzimin dhe këngën e Kishës, "Lavdi Hyjit në të lartin qiell e paqe njerëzve vullnetmirë mbi tokë".

Kërshëndellat, në thelbin e vet, bartin ftesën e Zotit për kthim kah Ai, kështu që ne, të cilët me sytë tanë arrijmë të shohim tërë botën, por jo fytyrën tonë, në shkëlqimin e dritës së Tij, e njohim bukurinë e shpirtit tonë.

Ftesa e Krishtit për kthim nuk është ofertë që të lëmë një gjë e të marrim diçka tjetër. Nuk është as kërkesë për me i ra mohit një religjioni e për të përqaftuar një tjetër. Por, është një ftesë për ta konvertuar zemrën, në mënyrë që ajo të mbushet me dashuri e të jetë e aftë ta dojë njerëzimin, tokën dhe qiellin, si Zoti; është ftesë për ta konvertuar shpirtin në

Shpirt të Zotit, që na bën më të mirë, më të dhimbshëm, më të mëshirshëm, më të butë, më të drejtë e më të shenjtë. Ky ndryshim na bën njerëz të rinj, që bartin në vete lajmin e mirë të shpëtimin; shndërrohemi në burim dashurie, bëhemi bartësit e paqes dhe dëshmitarët e Zotit.

Vëllezër e motra, po ta arrinim këtë nivel feje, këtë hapësirë dashurie dhe këtë mundësi shenjtërimi, atëherë të gjithë ne do të ishim më të shenjtë dhe jeta jonë më ndryshe. Kështu që, në mesin tonë, nuk do të kishim të varfër që këtë dimër jetojnë pa strehë; nuk do të kishim konflikte e mosmarrëveshje me njëri-tjetrin e as mes atyre që bartin përgjegjësi publike ose pushtet politik. Po ashtu, nuk do shihnim se si rrezikohet fati i popullit dhe si frenohet vullneti i qytetarëve, duke e zvarritur dialogun. Por, do t'i kishim tashmë institucionet e shtetit e do t'i shihnim duke iu shërbyer qytetarëve, duke bashkëpunuar për të mirën e vendit, duke punuar së bashku për përparimin e jetës së njerëzve dhe duke u përpjekur që të arrihet pajtimi mes popujve.

Nuk mund të mos i kujtoj, këto ditë, gjithë ata shpirta që ua ndërpreu jetën tërmeti në Shqipëri. Ata të plagosur që ende lëngojnë nga plagët e marra, atë trishtim dhe ata lot të fëmijëve, të burrave e grave dhe të gjitha ato familje të mbetura pa strehë e pa shpresë në këto net dimri.

Në anën tjetër, dua t'i falënderoj dhe t'u shpreh mirënjohje të gjithë njerëzve e institucioneve, që gjatë kësaj kohe kanë ofruar shërbime të llojllojshme, kanë dhanë ose kanë grumbulluar ndihma dhe ata që kanë ofruar përgatitjen e tyre profesionale në përpjekje për t'u ndih-

muar njerëzve. I nxisim të vazhdojnë të bëjnë edhe tutje të njëjtën gjë. Zoti e shpërbleftë veprën e të gjithë atyre që bëjnë mirë mbi tokë. Megjithatë, nuk mund të mos theksoj edhe mangësitë që shfaqen rreth nesh, e që nuk janë të pakta. Por, më e pakuptueshme ndër to është që eksponentët politikë, as në këto momente fatkeqësie, s'po arrijnë të bashkëpunojnë në të mirë të vendit e në dobi të njerëzve. E, lëre më të gjejnë rrugën e paqes e të pajtimin të përhershëm.

Mbi gjitha, është e çuditshme dhe e dhimbshme njëkohësisht që, gjithandej ku jetojnë shqiptarët, ndihet njëlloj mosbesimi kolektiv tek e ardhmja më e mirë. Dhe, vërehet qartë se si disa i frenojnë proceset që na shpian kah ky qëllim. E, në anën tjetër, nuk mungojnë edhe ata që me kryeneçësi duan të na shpian të gjithëve te fati që kanë paracaktuar për ne.

Kjo kohë bëhet edhe më e pakuptueshme, kur disa anëtarë të familjes evropiane, në vend që të na ndihmojnë të nxjerrim në pah identitetin tonë evropian, na gjykojnë për mbishtresat kulturore dhe na shtynjë te iniciativa "hibride", duke na konsideruar si një etnitet politik, ndryshe nga ta.

Nisur nga gjithë kjo që kemi përjetuar dhe kemi parë deri më tani, nxitemi edhe më tepër ta lusim Zotin për vendin(et) dhe për të ardhmen tonë, që kjo festë e Kërshëndellave të bëhet një burim shprese, jete dhe dashurie për secilin prej nesh e të na mundësojë të gjithëve të kemi më shumë paqe, dashuri, mirëkuptim dhe pajtim.

Për shumë mot Krishtlindjen dhe urime Vitin e Ri 2020!

Ipeshkvi Juaj,
+ Dodë GJERGJI

Liderët urojnë për Krishtlindje

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe liderët e partive politike në vend i kanë uruar besimtarët e krishterë për Krishtlindje. "Të gjithë besimtarëve të krishterë ua uroj Kërshëndellat, duke u dëshiruar shëndet, lumturi dhe shumë gëzime në familjet e tyre. Në këtë natë të bekuar t'i ripërtërijmë vlerat njerëzore dhe shpirtërore, duke rritur mirëbesimin, solidaritetin dhe humanizmin me njëri-tjetrin", ka uruar presidenti Hashim Thaçi. Për festën e Krishtlindjes, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ua ka përcjellë urimet më të përzemërta të gjithë shqiptarëve katolikë, besimtarëve të krishterë si dhe miqve ndërkom-bëtarë që shërbejnë në vendin tonë. "Si popull i një trungu ne për-

mijëra vjet kemi festuar së bashku, duke i dhënë kuptim thelbit të festës, lajmin e mirë, shpresën, faljen, dashurinë dhe harmoninë ndërmjet njerëzve. Uroj dhe punoj që kjo traditë unike të rrënjohet si parim i përhershëm dhe model për shoqërinë dhe shtetin tonë. Uroj që Krishtlindjet të sjellin paqe nën kulmin e secilit prej nesh. Buzmi le të ndriçojë e të ngrohë çdo familje! Për shumë mot e jetë!", ka thënë Haradinaj në urimin e tij.

Edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ka uruar besimtarët për Krishtlindje. "U uroj një festë sa më të lumtur, pa lënë mënjënjë mesazhin e solidaritetit dhe ndihmës për të varfrit e të diskriminuarit. Si çdo fe e madhe, krishteri-



mi ia përkujton njeriut kufijtë e individualizmit dhe të metat e egoizmit, dhe e drejton atë kah e mbara: puna e përkujdesja për tjetrin, për bashkësinë, familjen, fqinjën, bashkëqytetarët, bashkëkombësit dhe mbarë njerëzimin. Gëzuar Krishtlindjen!", ka shkruar Kurti.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka uruar që kjo festë ta gjejë popullin e Kosovës të bashkuar, në mirëqenie dhe plot begati. "Të gjithë qytetarëve të besimit të krishterë, për shumë mot Krishtlindjen! Uroj që kjo kremte t'i gjejë familjet tuaja të mbushura me shëndet, harmoni dhe dashuri. Festa e Krishtlindjes

le ta gjejë popullin e Kosovës të bashkuar, në mirëqenie dhe plot begati. Gëzuar Krishtlindjen për të gjithë besimtarët e krishterë!", është thënë në urimin e kryetarit të LDK-së.

Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka uruar të gjithë besimtarët e krishterë për mbarësi. "Gëzuar Krishtlindjen! Paqe, mbarësi dhe begati për të gjithë!", ka shkruar Veseli.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se në këtë ditë të shënuar uron për më shumë mirëqenie e begati në familjet tuaja. "Solidariteti dhe harmonia ndërfaqetare janë vlerat tona ndër shekuj të cilat do t'i kultivojmë në vazhdimësi", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.

Importi i mallrave në Kosovë kap vlerën 297,6 milionë euro

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 9.2 për qind në muajin nëntor 2019, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 262,2 milionë eurosh krahasuar me deficitin 240,1 milionë euro në vitin 2018



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin nëntor 2019. Sipas ASK-së, të dhënat nga tregtia e jashtme të mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 9.2 për qind në muajin nëntor 2019, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 262,2 milionë eurosh krahasuar me deficitin 240,1 milionë eurosh në vitin 2018. Eksporti mbulon importin 11.9 për qind. "Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2019 kishte vlerën 35,3 milionë euro, ndërsa importi 297,6 milionë euro. Është një rritje prej 1.9 për qind për eksport si dhe 8.3 për qind për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 32.5 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 14.1 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 9.8 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 7.6 për qind produktet minerale, 6.3 për qind produktet bimore, 5.9 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 5.8 për qind artikujt e ndryshëm të prodhuar etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import e përbëjnë: 13.7 për qind produktet minerale, 13.5 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 12.4 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 10.5 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 8.6 për qind mjetet e transportit, 6.9 për qind produktet e industrisë kimike, 6.5 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj", është thënë në raportin e ASK-së,

duke shtuar se eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 15,6 milionë euro, ose rreth 44.1 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 48.8 përqindësh. Partneret kryesore për eksportin e mallrave në BE janë: Italia (14.1 për qind), Gjermania (10.0 për qind), Holanda (4.6 për qind), Britania e Madhe (2.2 për qind) etj. Ndërkaq importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 141,6 milionë euro, ose 47.6 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 12.5 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13.5 për qind),

Italia (5.5 për qind), Bullgaria (3.8 për qind), Sllovenia (3.3 për qind), Polonia (3.3 për qind) etj. Në muajin nëntor 2019, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 13,7 milionë euro, ose 38.8 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 10.7 përqindësh. Partneret kryesore për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria (14.0 për qind), Maqedonia (12.6 për qind), Serbia (5.5 për qind), Mali i Zi (4.8 për qind). Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s në muajin nëntor 2019 arritën në 41,3 milionë euro, ose 13.9 për qind të importeve të përgjithshme, me një rënie prej

26 përqindësh. "Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia (6.7 për qind), Shqipëria (5.8 për qind) dhe Serbia (0.1 për qind). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 6 milionë euro, ose (17.1 për qind). Si partner më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmendën: Zvicra (9.1 për qind), Turqia (3.7 për qind). Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 114,6 milionë euro, ose (38.5 për qind). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (15.9 për qind) dhe Kina (9.8 për qind)", është thënë në fund të raportit të ASK-së.

Taksa rriti vetëbesimin në prodhim

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka vizituar të martën Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB), ku është pritur nga kryetari i saj, Agim Shahini, me bashkëpunëtorë, ndërsa pas takimit ka marrë pjesë edhe në konferencën përmblylëse të vitit të AKB-së. Në këtë konferencë, Haradinaj ka thënë se viti 2019 nuk ka qenë vit i lehtë për ekonominë e vendit, duke kujtuar disa ngjarje që e kanë shënuar këtë vit. "Mendoj se është e arritur e madhe fakti se ka arritur të implementohet Ligji për 'Trepçën' sepse duke u implementuar ky ligj për 'Trepçën' jep disa efekte: E para, krijon situatë të pastër të statusit ligjor të resurseve në vendin tonë, të gjitha resurseve, pra me këtë përmbillet kapitulli se të kujt janë resurset ose pasuritë natyrore të vendit tonë dhe kësaj 'Trepça' është e gatshme për të operuar dhe për të bërë biznes.

Për herë të parë pas vendosjes së taksës e kemi zbuluar veten se kush jemi në ekonomi, sepse taksa na ka detyruar të balancohem me vetveten, tregtarin, prodhuesin dhe shërbyesin. Duhet t'i gëzohemi faktit se tani e njohim veten në prodhim, kush jemi ne, kush është Kosova, kush është ekonomia e Kosovës në prodhim. Është hera e parë që e kemi rritur vetëbesimin në prodhim, në produktet tona dhe në ekspertizën tonë. Konsumatori, qytetari i Kosovës, është njohur me to dhe kjo është një ngjarje e madhe", u shpreh Haradinaj. Ai ka deklaruar se është e vërtetë se është rritur eksporti i Shqipërisë për 30 për qind në Kosovë. "Është gabim i madh vendosja e taksës në Rrugën e Kombit dhe e çmimit për skaner për një transportues 42 euro. Kjo ka rezultuar me 13 milionë euro taksë për shkëmbimet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë", ka thënë ai. Kryeministri Haradinaj ka thënë se i është vendosur një dënim marrëdhënies Kosovë - Shqipëri



prej 13 milionë eurosh për qarkullimin e lirë të njerëzve e të mallrave. "Sikurse këto 13 milionë euro t'i kishim investuar në lehtësirat e qarkullimit të ndërsjellë, jam i sigurt që prej atyre 450 milionëve Shqipëria do të mund të ishte rritur shumë. Kjo tregon se ne nuk i kemi kryer

detyrat e shtëpisë Kosovë - Shqipëri por, përkundrazi, i kemi vendosur vetes pengesa duke e fajësuar njëri-tjetrin", u shpreh ai. Ndërkaq kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka folur për zhvillimet pozitive që i ka sjellë për

ekonominë e vendit vendosja e taksës duke e falënderuar kryeministrin për qëndrueshmërinë e tij në këtë çështje. Ai ka thënë se efekti i taksës ka qenë shumë i madh dhe ka rritur qarkullimin e brendshëm mbi 100 milionë dhe punësimin në rreth 5 000 të rinj.

Arti i vështirë i të jetuarit në paqe



Bedri ISLAMI

Disa ditë më parë unë i drejtova një letër të hapur mikut tim, Ismet Sylejmani, si mendim, përsiatje për pushtetin, njeriun dhe artin e vështirë të jetuarit në paqe. Mbrëmë, kur po vija i ftuar në Kongresin e Katërt Zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim, jo rastësisht me është kujtuar kjo letër, ashtu si me erdhën në mend rrugët që kemi bërë të gjithë së bashku, për të ardhur në këtë çast, i cili, edhe pse mund të duket i zakonshëm, është i rëndësishëm jo vetëm për shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në shtetin maqedonas, por shumë më gjerë se kaq.

Rrugët, miq të dashur, janë ato që bashkojnë njerëzit, por edhe mund t'i ndajnë ata. Liderët e vërtetë ngritin rrugë për bashkimin e njerëzve dhe jo për ndarjen e tyre, forcat e vërteta politike ringritin ide, vizione dhe pasione politike të cilat u shërbejnë njerëzve për t'i bashkuar.

Në të vërtetë, letra ime erdhi pasi kisha menduar gjatë për pushtetin, njerëzit që e përbëjnë atë dhe artin e vështirë të të jetuarit në paqe. Në mendje kisha staturën e një lideri të veçantë, i cili, në rrugëtimin e tij politik, gjithnjë u ka dhënë më shumë rëndësi realiteteve konkrete sesa të drejtave abstrakte dhe mundimshëm ka ngritur një ngrehinë solide të mendimit politik shqiptar, e cila, po aq sa nga bashkëkombësit, do të shquhet edhe në vizionin e së ardhmes. E kisha fjalën për Ali Ahmetin, liderin politik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. 27 vite më parë e kam njohur Ali Ahmetin. E kam njohur në një kohë të vështirë, ndoshta më të mundimshmen e jetës së tij, atëherë, kur ai, si njeri nder

themeluesit dhe drejtuesit kryesor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bënte pjesë në atë elitë që kishte projektuar të ardhmen, jo përmes pritjes dhe konferencave, por, si detyrim kombëtar, përmes luftës. Ka qenë e vështirë, tejet e mundimshme dhe e rrezikshme, por e domosdoshme.

Ne ndejat e gjata, familjare apo në kryesinë e Organizatës që krijoi ushtrinë çlirimtare, ku bënim pjesë të dy, ai nga fillimi dhe unë më pas, shumë gjëra mund të jenë harruar, por kurrë aspirata për lirinë, dinjitetin; në fund të fundit ai ishte njeriu që kishte vizionin e qartë, mendimin e sigurt dhe rrugën e duhur që kishte zgjedhur.

Përse e shkrova letrën që citova në fillim të kësaj fjale dhe përse tani po shtroj idenë e mbështetjes së BDI-së dhe të Ali Ahmetit? Në Shqipëri, gjendja është konfuze, oligarkia politike dhe financiare po mbjell një të ardhme të paditur, por kurrsesi të dobishme, dhe forcat e vjetra të errësirës janë rizgjuar. Në Kosovë, po ashtu, e keqja është bërë e pranishme dhe, çka është më keq, është bërë e pranueshme.

Në Maqedoninë Veriore ka më tepër qetësi, më shumë ecje drejt demokratizimit, megjithëse aty duhej të kishte më tepër probleme dhe unë jam i bindur se, miku ynë i përbashkët dhe drejtuesi i më i lartë politik i shqiptarëve, Ali Ahmeti, luan rolin e tij të pazëvendësueshëm. BDI-ja është bërë sot, e më shumë do të jetë në të ardhmen, shpirti i mendimit të ri politik, e bartjes së një vizioni gjithnjë e më shumë evropian, e vizionit të qartë për të ardhmen dhe e domosdoshme për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut. Pa BDI-në e aq më tepër kundër saj, e ardhmja e këtij shteti nuk mund

të perceptohet dhe drejtësia nuk mund të sigurohet.

Shteti ku ndalohej gjuha shqipe, sot ka tre universitete në gjuhën shqipe, njëri nga të cilët në Shkup, me emrin e "Nënë Terezës".

BDI-ja nuk është krijim i një njeriu, por ai u bë jo vetëm themeluesi, por edhe shpirti i saj. E vështirë të perceptohet BDI-ja pa liderin e saj, Ali Ahmetin.

Maturia dhe shpirti i tij jashtë konfliktit, siguria për të ecur qetësisht dhe duke e ditur se ku duhet të shkojë në të ardhmen, krijimi i një marrëdhënie të re ndërnacionale, afrimi i shumë intelektualëve drejt për bashkimin, shtrirja e rrjetit të mendimit të lirë drejt njerëzve, koncepti i drejtë për shtetin dhe për Republikën, e kanë bërë praninë e tij të domosdoshme dhe, përmes pranisë së tij, kanë sjellë për ditë e më shumë staturën e një lideri madhor, jo tipik ballkanik, por evropian i klasit të parë dhe, në fund të fundit, modelin e një shqiptari të politikës që nuk hedh gurë ndaj të tjerëve, por ngrë urat e bashkimit. Jam i bindur se edhe më tej Ali Ahmeti, duke pasur konceptin e drejtë të ndërtimit të shtetit shumëdimensional dhe tejet funksional, do të jetë njeriu i paqes, ashtu si ishte njeriu i luftës.

Do të jetë njeriu që i besoi Fehmi Lladrovci në kohën e luftës dhe do i kishte besuar edhe në këto ditë. Mbetet njeriu që ndërlihi forcën dhe emrin e Adem Jasharit me një çështje të madhe dhe që sot, përsëri, do të kishte mbështetjen e tij. Në mendimin tim nuk mbështetem asnjëherë në miqësinë tonë të përbashkët, në relatat e krijuara nga vitet, pasi për mua, më shumëse çdo miqësi, qëndron kombi dhe e vërteta, qëndron amaneti i atyre që u flijuan, por, Njeriu i vërtetë, si

kam shkruar në njërin nga librat e mi, vazhdon të qëndrojë i vërtetë. Unë e kam ndjekur aktivitetin e tij edhe në ditë të vështira për Lëvizjen, për luftën, për zhvillimin; e kam ndjekur kur pak vetë besonin se do të kishte një të ardhme të tillë dhe kur shtigjet dukeshin të mbyllura përjetësisht. Pra, njohja jonë më ka shërbyer për të shikuar më gjerë, për të ditur më shumë, për të gjykuar më qetësisht, për të analizuar më thellë, për të përcaktuar më saktë, për t'u përqendruar më gjerë dhe, sot që po të shkruaj, më vjen keq që në politikën shqiptare të trojeve tona nuk kemi nga një Ali Ahmeti në çdo pjesë. Mungesa e një burri shteti në përmasat e tij është mungesë e vlerave dhe këtë e ndjej përditë e më shumë. Më duhet të shtjelloj më tej idenë e "kërkimit" të një lideri si Ali Ahmetit. Unë e di se ku banon ai dhe mes cilëve banon. Ndoshta i vetmi lider shqiptar që bëri banesën e tij në fshatin e lindjes, në shkallët e së cilës eci për herë të parë nënëlokja e tij. Por unë jam përtej saj. Ali Ahmeti është nga ata liderë dhe prej atyre rasteve që vërtetën se historia e një kombi mund të kthejë rrugën e saj nga vendosmëria e një njeriu të vetëm. Maqedonia u kthye ne rrugën e demokratizimit dhe shtetit ku te drejtat e shqiptarëve marrin hapësirë gjithnjë e më shumë nga ushtria Çlirimtare Kombëtare dhe lideri i saj. Askush nuk guxon të harrojë këtë fakt. Gjaku i shqiptarëve e mban këtë shtet, të cilët, edhe në ditën më të vështirë u treguan tolerantë, të hapur, bashkëpunues, por këmbëngulës për të drejtën e tyre. Zakonisht, vepra e njerëzve të shquar është e qëndrueshme në atë masë sa ata mbajnë parasysht erërat e mëdha të historisë, sa ndikojnë në rritjen dhe ecurinë e njerëzve, çfarë përparësie sjellin me veprimet e tyre, cili është vizioni i tyre dhe rrugët e përcaktuara. Kam ëndërruar gjithnjë që viset shqiptare, pavarësisht se të ndara në shumë pjesë, të kishin një trupë drejtuese, aspak të korruptuar, të ngjeshur me kulturë elitare dhe ku pushteti të mos kishte asnjë ndikim mbi ta. Një elitë politike që nuk do të influencojë as nga joshjet, as nga frikësimet, pjesët e së cilës të ushtronin me kryelartësi privilegjin për të bërë ligje të drejta, të sendërtonin shtetin, të kritikonin dhe të rebeloheshin ndaj një qeverie të padrejtë, dhe më pas, pasi kishin thënë çfarë mendonin dhe kishin ndërtuar ligje të drejta, të ktheheshin në shtëpi në këmbë, pa frikë, të ruajtur prej mërive nga mbështetja e popullit. Një elitë e tillë nuk bëhet vetvetiu. Ajo kërkon një lider, vetitë e të cilit të

jenë serioziteti dhe besnikëria, të jetë i veçantë dhe i qëndrueshëm, të ngrejë ura dhe jo hendeqe ndarëse, një lider, nga i cili, askush të mos ndahet prej tij pa e ndjerë veten më trim dhe më të aftë për të shërbyer ndaj vendit të tij. Një lider i tillë është Ali Ahmeti. I pabujë në qëllimet e tij, i qetë në egërsinë e politikës, i hapur kur të tjerët mbyllen, i palirë në robërinë e të tjerëve, i lirë në lirinë e tij; përbuzës për të keqen dhendikues i së mirës, i ndodhur shpesh herë në mesin e tallazeve të sulmeve nuk i përdori kurrë ato; i gjendur në fundin e greminës dhe i ngjitur në majën e saj; i parënë në hone dhe ngritës urash, njeri i lexuar dhe ngarendas i mendjes para shfrimit të linçimit.

Ndoshta mund të jetë nga njerëzit e sulmuar ashpërsisht, por që nuk e përdori pushtetin për të marrë hakën e tij, por për të marrë hakun e popullit që i takonte dhe këtë, jo përmes sherrit, por mendjes dhe arsyes. Të gjitha këto që i ka arritur sot, i ka planifikuar në vite të tëra. Që nga fillimi i vitit 1981 e ka ditur se ku do të ishte fundi i tyre; që kur janë ngritur këshillat e parat të lëvizjes çlirimtare e ka menduar se çfarë do të ndodhë pas çlirimit.

Tani, miq te dashur, shikoni përballë.

Në Kosovë, ku njëra nga ëndrrat e mia ishte drejtimi i saj nga njerëzit e luftës, më sjell trishtimin. Katër nga pesë partitë kryesore politike në Kosovë kanë fillësën nga njerëzit e luftës. E megjithatë, pikërisht ata janë ndarëset e mëdha dhe jo bashkueset e mëdha, çka duhej të ndodhte. Nga rrjedha e tyre humbet vlera e luftës. Nga pasuria e tyre zvenitet gjaku i derdhur. Nga egoja e pushtetit kthehen në mercenarë. Nga ndarja kthehen në humbës. Çlirimtarët janë të palirë. Shërbëtorët e djeshëm të regjimit shfaqen si patriotë. Dhunuesit e lirisë marrin pamjen e atdheadashëve.

Në shtetin amë, ku kam lindur, egërsia i ka lënë vendin mendimit, liderët janë kthyer në manjatë, oligarkët kanë pushtuar politikën, britmat ndjellin luftën liderët kanë hapur blloqet e dikurshme dhe po zezojnë Shqipërinë duke marrë nëpër këmbë dinjitetin e saj. Për fat të keq, as në Kosovë e as në Shqipëri, nuk kemi një figurë rreth të cilit të shkohet duam të bashkohemi, le të krijojmë urat e përbashkëta. Rrugë tjetër nuk ka. BDI-ja i ka krijuar këto, ndaj do të jetë fituese, më patjetër, e zgjedhjeve të 12 prillit të vitit 2020.

Unë jam i bindur për këtë!

(Fjalim i mbajtur në Kongresin IV Zgjedhor të BDI-së)

Kosova e pasluftës (3)

Bisedimet me Serbinë dhe Gjykata Speciale



Shkruan: Izmi ZEKA

Bisedimet me Serbinë pa dashur determinuan politikat dhe hapat e mëtuqshëm të shtetit të Kosovës. Mosunifikimi i skenës politike dhe loja e paqartë e politikës sonë bëri që ne të jemi në disavantazh me shfrenimin diplomatik e politik të Serbisë. Disa parti politike dashur apo pa dashur sillëshin sikur ne të jemi qendra e botës dhe të jemi faktor crucial për determinimin e përgjithshëm të Ballkanit dhe politikave të tij. Vetvetiu ne filluam të dalim të paqartë në BE, të pakonsoliduar dhe tejet të dekompozuar, gjë që ndikoi edhe në raportet tona me miqtë tanë qoftë evropiane dhe amerikanë. Kjo ishte një pjesë, por kemi edhe shumë faktorë që ndikuan në raport me Kosovën për këto situata jo të mira në raport me të tjerët.

BE-ja nuk arriti t'i mbajë premtimet e dhëna dhe u tregua jokorrekte me premtimet në raport me shtetin e Kosovës. Shikuar në syrin e vlerësimit, BE-ja sikur luante me dualitet në raport me neve dhe Serbinë, gjë që ndikoi edhe në hezitimin dhe besueshmërinë e Kosovës në raport me BE-në.

Mosliberalizimi i vizave dhe përkëdhelja e Serbisë ishin dhe janë të mjaftueshme për të krijuar një opinion dhe anësi se

trajtimi nuk ishte i nivelit të barabartë.

BE-ja duke luajtur me lojën tërhiq e mos e këput në mënyrë indirekte dëmtoi proceset e rëndësishme të Kosovës dhe pengoi ecjen e saj. Gjykata Speciale ishte dhe mbetet një luftë e egër dhe tejet e individualizuara duke i dhënë një shuplakë shtetit të Kosovës përmes individëve të UÇK-së e ku katërçipërisht luftohet lufta e UÇK-së.

Kjo gjykatë nuk është e rastit dhe nuk është bërë pa ndonjë qëllim të caktuar ku për të balancuar egërsinë serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës qarqe të caktuara dëshirojnë ta devalvojnë një proces historik. Lufta politike dhe diplomatike e qarqeve pro serbe në Evropë e më gjerë natyrisht edhe me ndihmën e njerëzve tanë në Kosovë që nga paslufta duke deponuar gjithçka qoftë në UNMIK, EULEX dhe të gjykatat serbe imponuar krijimin e kësaj gjykate që për bazë ka një etni që shikuar në historitë botërore vështirë se gjendet ndokund që i robëruari dhe ai që ka mbrojtur pragun e shtëpisë të barazohet me agresorin. Kjo ndodh në Evropën e qytetëruar ku ligjërohet në përditshmëri barazia, të drejtat e njeriut, humaniteti etj. Luftërat çlirimtare kanë një mision çlirim dhe asgjë më shumë. Natyrisht aty nuk ka vend për shërbëtor të armikut dhe njerëz që shiten dhe punojnë për armiqtë e popullit.

Francezët nuk kanë pyetur kurrë gjatë dhe pas luftës së dytë botërore për eliminimin e shërbëtorëve të shteteve tjera kur kishte të bënte me shtetin e tyre.

Gjenocidi dhe masakrat në Kosovë të bëra nga shtetit serb ishin mision i organizuar shtetëror. Edhe sot kur po shkruajmë shteti serb ende nuk është gjykuar për krimet që i ka bërë në Kosovë dhe vende të tjera e që ka qenë sistem i përfeksionuar dhe qasje për likuidimin e shqiptarëve të Kosovës vetëm pse ishin shqiptarë dhe donin lirin e tyre.

Lufta politike e BE-së dhe bilanci në raport me Kosovën dhe mbështetja e fuqishme e Rusisë ka arritur që shteti serb të luajë në dy rrafsh për të ruajtur supremacinë në Ballkan e më gjerë.

Evropa duke tentuar shpëputjen nga ndikim rus ka lejuar që Serbia të rikthehet në Ballkan dhe ende të mos pranojë gjenocidin e bërë në tërë Ballkanin. Mosndëshkimi i shtetit serb për të bërë luftërat në Ballkan kanë sjellë një gjendje e cila në vend të ndëshkimit kemi përkëdhelje të përditshme e që në fakt po dëmtohen interesat vitale të zhvillimit dhe civilizimit të popujve të Ballkanit. Mosndëshkimi i kriminelëve dhe i krimit në Ballkan shfaq mundësinë e përsëritjes dhe kthimin në pikën zero të investimeve qoftë Amerikane dhe Evropiane në Kosovë e më gjerë. Serbët historikisht por edhe traktatet e ndryshme kanë dëmtuar interesat kombëtare shqiptare.

Revista mujore franceze 'Le Cris des Peuples' më 4 mars 1929 ka botuar shkrimin e Fan Nolit, i cili gjendet në faqen 18. Serbët dhe grekët po ushtronin metoda barbare shpronësi, dëbimi dhe asgjësimi ndaj bashkatdhetarëve tanë, të cilët,

për arsye të politikave makiavelike, fatkeqësisht u gjendën jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë. Në vijim, analiza alarmuese e Fan Nolit përreth kësaj situatë: "Diktatura jugosllave peshon rëndë mbi të gjithë popujt e nënshtruar nga militaristët serbë. Ajo është shtypëse për shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të Ulqinit, Tivarit, Hotit, Grudës, Plavës, Gucisë dhe Dibrës, të aneksuara me radhë në vitin 1880, 1912, 1919 dhe 1924 nga Serbia. Bëhet fjalë për afërsisht një milion banorë të privuar nga të drejtat më bazike. As edhe një shkollë e vetme shqiptare për këtë popullatë kompakte që e kalon numrin e asaj të Shqipërisë së pavarur e të gjymtuar nga Traktatet. Asnjë shoqatë, madje as për bamirësi, nuk është lejuar për ta. Asnjë anëtar nuk i përfaqësonte në Skupshtinën (Kuvendi Serb) e shpërbërë. Udhëheqësi i tyre, Ferhat Draga, u dënua me njëzet vite burgim për kryerjen e krimit në lidhje me shpalljen e rikandidimit të tij për t'u rizgjedhur në zgjedhjet e fundit parlamentare. Kolegu i tij, ish-deputeti Nisam Xhafurri (Gjafuri), u vra pabesisht në vitin 1927, për të njëjtën arsye. Rivali i tyre, Jusuf Ahmeti, u vra kohëve të fundit, për arsye se guxoi të zgjidhej anëtar i këshillit bashkiak të qytetit të Prishtinës".

Noli me pak fjalë ka thënë shumë, andaj sot duhet të rikthehemi në histori dhe veprimet të jenë në harmoni me politikën dhe strategjitë kombëtare.

Po ashtu e thënë mirë nga

rilindësi i përmasave Evropiane Sami Frashëri në veprën "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet". Dy gjëra duhen në këtë jetë: e drejta dhe fuqia.

E drejta pa fuqi, si dhe fuqia pa të drejtë, është si një krah i vetëm; ndonjë zog s'fluturon dot me një krah. Më të rrallë bën punë fuqia pa të drejtë, edhe e drejta pa fuqi fort rrallë dëgjohej. Peshku i madh e ha gjithnjë të voglin.

Tani shqiptarët, që e kanë të drejtën me vete, aty s'ka dyshim. Qysh të mos ketë shqiptari të drejtë të shkruajë e të këndojë gjuhën e tij, kur gjithë kombet e kanë këtë të drejtë dhe njeri s'i ndalon? Pse shqiptarët të jenë të mërguar nga një e drejtë që e kanë gjithë kombet e dheut? Të mos mundin të shkruajnë e të mësojnë gjuhën e tyre, po të tjera kombe të huaj të vijnë e t'u hapin shkolla në gjuhët e tyre e t'u kthejnë kombësinë e gjuhën e tyre? Janë kaq të dobët shqiptarët? Jo! një mijë herë jo...!

Pamë më sipër se sa trimëri kanë bërë shqiptarët. Këta që kanë treguar trimëri për të huajt, të cilët edhe s'para ua kanë ditur, s'qenkan të zotë sot të mbajë e të ruajnë vendin, gjuhën, kombësinë e tyre? Qysh të mos jenë të zotë për këtë të drejtë, kur kanë edhe vendin e fortë që u ndih?... Një trim që lufton për plaçkë e për rrëmbim është kurdoherë i turpëruar; ai që lufto për një të drejtë të këtyllë është dy herë trim; e drejta i jep një forcë e një fuqi që s'e lë kurrë të mundet, po e bën njerin të mundë dhjetë! (Vijon)

Xhabir Zharku mbetet në paraburgim



KAÇANIK, 24 DHJETOR (ER) - Gjykata e Apelit e Kosovës e ka refuzuar të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës, kundër vendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit prej një muaji ndaj ish-kryetarit të Komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku. "Xh. Zh. po dyshohet nga ana e prokurorisë për shkak të dy veprave penale 'Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit' nga neni 339, par. 1, lidhur me nenin 3 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e

shkallës së parë ka vlerësuar drejt meqenëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri i ka kryer veprat penale në fjalë, ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ngaqë ka arsye për të besuar se me gjetjen e tij në liri, i njëjti mund të ikë ose arratiset, me qëllim të shmangies së procedurës penale, apo të ndikoj në prova ose dëshmitarë, me qëllim të pengimit të rrjedhës normale të saj", është thënë në komunikatën për media të kësaj gjykate.

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,

Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

- Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,

We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

- Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,

Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

- Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!

Gëzuar Krishtlindjen!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net

Gëzuar Krishtlindjen
dhe Vitin e Ri

vala
KOSOVO TELECOM

www.kosovotelecom.com

MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

Johnsoni: Kam gabuar, nuk rikrijohen marrëdhëniet me Rusinë

LONDËR, 24 DHJETOR - Kryeministri britanik, Boris Johnson, ka thënë se "ka gabuar" për Rusinë dhe se nuk beson më që është e mundshme të rikrijohen marrëdhëniet me Moskën, teksa shtetet kanë shumë dallime në qëndrime. "Për çfarë njëmend kam ndërruar mendje ka qenë nëse mund të rikrijohen marrëdhëniet me Rusinë. Unë vërtet kam menduar si edhe shumë sekretarë të jashtëm dhe kryeministra në të

kaluarën se mund të nisim nga fillimi me Rusinë. Ai është shtet fantastik me të cilin kemi luftuar fashizmin. Është shumë zhgënjyese që isha gabim", ka thënë Johnsoni për revistën British Spectator. Këto komente vijnë pasi Johnsoni ka thënë më 21 dhjetor, gjatë një vizite në Estoni, se shpreson që do të përmirësohen marrëdhëniet me Rusinë, ndonëse të dyja shtetet kanë "probleme të

tmerrshme" që i ndajnë. Johnsoni i ka bërë këto deklarata në një intervistë në Estoni teksa ka vizituar 850 ushtarë britanikë që shërbejnë në shtetin baltik për të luftuar atë që Perëndimi e sheh si agresion të Rusisë, pas aneksimit të Krimesë nga Ukraina dhe mbështetjes së separatistëve në lindje të këtij shteti. Ky konflikt ka lënë të vrarë më shumë se 13,000 persona nga viti 2014.



Republikanët dhe demokratët përplasen për procedurat e gjyimit të Trumpit

Demokratët dëshirojnë që gjatë gjyimit në Senat të lejohen dëshmitarët dhe dokumentet, për të mundësuar atë që ata e përcaktojnë një gjykim të drejtë. Dhoma e Përfaqësuesve votoi dy akuzat kundër presidentit Trump gjatë javës së kaluar



WASHINGTON, 24 DHJETOR - Udhëheqësit republikanë dhe demokratë në Senatin e ShBA-së janë përplasur lidhur me rregullat që duhen ndjekur, në gjykimin për shkarkim ose jo të presidentit amerikan Donald Trump.

Demokratët dëshirojnë që gjatë gjyimit në Senat të lejohen dëshmitarët dhe dokumentet, për të mundësuar atë që ata e përcaktojnë "një gjykim të drejtë".

Udhëheqësi demokrat Chuck Schumer thotë se rrjedhja në publik e një email-i në lidhje me ndihmën për Ukrainën është një rikujtesë për gjykim të hapur. Udhëheqësi republikan, Mitch McConnell, thotë se dëshmitarët nuk janë përjashtuar.

Dhoma e Përfaqësuesve votoi dy akuzat kundër presidentit Trump

gjatë javës së kaluar. Ai akuzohet për shpërdorim të pushtetit dhe pengim të punës së Kongresit. Hetimi ndaj tij filloi pasi një informator i paidentifikuar e informoi Kongresin për një telefonatë midis presidentit Trump dhe homologut të tij ukrainas, Volodymir Zelenksyit, e zhvilluar në korrik të këtij viti. Sipas tij, gjatë bisedës Trump i kishte kërkuar Zelenskyit që Ukraina ta hetojë për korrupsion rivalin e tij politik, Joe Biden dhe djalin e tij Hunter.

Joe Bideni është ndër pretendentët kryesorë për ta fituar nominimin e demokratëve për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.

Trumpi, gjithashtu, akuzohet se e ka kushtëzuar një ndihmë financiare të ShBA-së për Ukrainën, në këmbim të hetimeve të kërkuara.

Kjo bisedë telefonike e Trumpit nga demokratët u vlerësua si kërkesë ndaj një shteti tjetër, për të ndërhyrë në çështje të brendshme politike të ShBA-së. Sipas demokratëve, kjo përbën abuzim me pushtetin.

Por, demokratët deri më tani nuk kanë pranuar t'i dorëzojnë akuzat në Senat.

Ata duan siguri nga McConnell se dëshmitarët e tyre të zgjedhur - të

paktën katër ndihmës të tanishëm dhe të dikurshëm të Shtëpisë së Bardhë me njohuri për çështjen e Ukrainës - do të lejohen të dëshmojnë.

Republikani McConnell akuzoi kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, për mbajtjen e "një pozicioni absurd" lidhur me vonimin e dorëzimit të akuzave, dhe tha se ajo "me sa duket po përpiket të

na tregojë se si ta udhëheqim procesin gjyqësor".

Në bazë të procedurave ligjore, nëse akuzat për shkarkim votohen nga ana e Dhomës së Përfaqësuesve, atëherë çështja kalon në Senat, ku edhe merret vendimi përfundimtar për shkarkimin ose jo të presidentit amerikan.

Trump i ka mohuar të gjitha akuzat.

Kina, Japonia dhe Koreja e Jugut në një front kundër Koresë së Veriut



PEKIN, 24 DHJETOR - Kina mbajti të martën një takim trepalësh të nivelit të lartë me Korenë e Jugut dhe Japoninë, që kishte si objektiv shfaqjen e një fronti të bashkuar për t'iu bërë ballë qëndrimeve agresive të Koresë së Veriut.

Kryeministri Li Keqiang priti presidentin koreano-jugor Moon Jae-in dhe kryeministrin japonez, Shinzo Abe në qytetin jugperëndimor Chengdu, dy ditë

para të ashtuquajturës "dhuratë për Krishtlindje nga udhëheqësi koreano-verior, Kim Jong Un. Kim po kërkon lëshime të tjera nga Shtetet e Bashkuara deri në fund të vitit në këmbim të rifillimit të negociatave të bllokuara, që synojnë bindjen e Koresë së Veriut për të hequr dorë nga programi bërthamor.

Në komentet e tij hapëse, presidenti Moon tha se shtimi i tensioneve "nuk është as në të mirë

të vendeve tona, as të Koresë së Veriut".

Takimi trepalësh, u mbajt gjithashtu në klimën e një mosmarrëveshjeje në rritje mes Seulit dhe Tokios, lidhur me disa vendime gjyqësore në Korenë e Jugut, përmes së cilave urdhërohen kompanitë japoneze që të kompensojnë koreanët që ishin detyruar të punonin në komplekse japoneze gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Guterres bën thirrje për ndaljen e luftimeve në Sirinë Veriperëndimore

NJU JORK, 24 DHJETOR - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres ka bërë thirrje për ndaljen e menjëhershme të luftimeve në Sirinë Veriperëndimore ku

një ofensivë qeveritare, ka detyruar dhjetëra-mija vetë t'i lënë shtëpitë e tyre javën e fundit.

Një zëdhënës i Guterresit tha të hënën se është "i alarmuar

nga shkalla e operacioneve ushtarake dhe sulmet përgjatë rrugës së evakuimit, ndërsa civilët përpiqen të shkojnë në veri, për t'iu shmangur rrezikut".

Qeveria siriane po përpiket që të rimarrë kontrollin e provincës Idlib, zona e fundit që mbetet nën kontrollin e kryengritësve nga lufta civile që filloi në vitin 2011.



Historia e kremtimit të Krishtlindjes

Krishtlindjet janë sot festa kryesore e fesë kristiane, por tradita e festave përreth kohës së Krishtlindjeve është shumë më e hershme se sa krishtërimi vetë. Kur njerëzit varin nëpër shtëpi yje të ndriçuar dhe figura ëngjëjsh nëpër dritare dhe Santa Claus-ët (si? i thonë në botën anglofone) apo Nikolaus-ët (si? i thonë në botën gjermanofone) ngjiten nëpër ballkone, kur në korridore me dyqane vezullojnë bredha të zbukuroar dhe aroma e shijshme e kurabijeve të Krishtlindjeve ndihet kudo në atmosferë, atëherë për do njeri është e qartë: po afrohet sërish festa e Krishtlindjeve. Dita, në të cilën, sipas besimit kristian lindi fëmija Jezu. Që lindja e Krishtit bie në datën 24 dhjetor, kjo ka një simbolikë të thellë, tregon famullitari evangjelist Hans Mörtter: "Data 24 është data e parë, kur fillon të hapet qielli. Tek popujt paganë ka pasur edhe festa të dritës, pra kjo datë është prej mijëra vjetësh për të gjithë popujt një ditë shumë e rëndësishme. Kemi të bëjmë edhe me një histori shumë simbolike, që mbi njerëz pllakos herë pas here errësira, pra dhimbja, vuajtja, vdekja dhe se ekziston një kapërcim i këtyre dhe një mëngjes i ri. Bëhet sërish dritë. Është shumë e qartë, ne festojmë Krishtlindjet, sepse ne si njerëz të Oksidentit besojmë, se ekziston një figurë e përndritshme e Krishtit, e cila ka lindur

dhe ka jetuar, për të na treguar se paqja dhe drejtësia në këtë tokë janë të mundura, pra se është e mundur drita në errësirë, e cila na rrethon kaq shpesh, po të shohësh lajmet e përditshme."

Dhe kështu mbi grazhdin e Betlehemit ndriti një yll i Krishtlindjes, i cili u tregoi tre priftërinjve të shenjtë rrugën për në ?erdhen e Jezuit. Megjithëse shumë njerëz i zbukurojnë shtëpitë e tyre në periudhën e Krishtlindjeve me yje, shpesh harrohet kuptimi fillestar i simbolit, pra kërkimi i dritës hyjnore, shpreh keqardhjen famullitari Mörtter.

Në shekujt e mëparshëm njerëzit i dekoronin dhomat e tyre vetëm me pak degë të gjelbra; që në dhomën e ndenjes të vendoset bredhi i zbukuroar në mënyrë festive, ishte një ide që u lindi në shekullin e 16-të shoqatave të zanat?injve. Ata ishin të parët, që rreth vitit 1503 varën në pemë edhe gjëra të ëmbla për të ngrënë. Kurora e Ardhjes së Krishtit me katër qirinj të pasoi vetëm në vitin 1850: "Dhe kurora e Ardhjes së Krishtit është simbol i pritjes, Advent-mbërrir, "adventus", do të thotë pra se di?ka vjen tek unë, dhe ajo që vjen është vërtetësia hyjnore."

Në kohën e sotme, këtë famullitari Mörtter e di nga përvoja e tij personale, fëmijët nganjëherë i ngatërrojnë se kush është ai që



Natën e Shenjtë i vë dhuratat e tyre nën pemë: Santa Clausi, Nikolausi, plaku i Krishtlindjeve ose fëmija Krisht: "Është fëmija Krisht, është një fëmijë dhe jo plaku i trashë i Krishtlindjes, kush e thotë këtë, thotë gjëra jo të men?ura, ai shet kulturën dhe historinë tonë. Kjo nganjëherë më tmerron, kjo është shoqëria jonë e konsumit, e thënë tro?: jashtëzakonisht e varfër dhe qesharake." Famullitari Mörtter merr frymë thellë dhe vazhdon më tej: "Që fëmijëve t'u ruhet aspekti i fshehtësisë, për mua është me rëndësi: dhe puna fillon me mospërdorjen në mënyrë infla-

cioniste të plakut të Krishtlindjes ose Santa Clausit. Në rastin e Santa Clausit apo të Nikolausit nuk kemi të bëjmë me Santa Clausin e Coca Colës, por me Santa Claus-in e shekullit të katërt, me një peshkop. Ai është një figurë shumë e vjetër, një figurë mistike, një figurë shembull; ai u angazhua për njerëzit e uritur dhe kishte ide gjeniale." Krishtlindja është një festë kristiane, por për shumë njerëz degjeneron në terror të vërtetë konsumi. Veprimi i bërjes së dhuratave pa fund u përhap pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas mrekullisë ekonomike në Gjermani, na sqaron famullitari

Hans Mörtter. Më parë, ideja e bërjes dhurata kishte një kuptim të thellë: "Është Jezu ai që na bën dhuratë, ai që na bën dhuratë jetën e tij. Fëmijëve u bëheshin dhurata, në mënyrë që të kuptojnë se jeta është dhuratë dhe dhuratën e jetës ne e festojmë. Prandaj ka edhe dhurata, por jo në mënyrë të shfrenuar dhe që prindërit të vihen në stres. Çfarë kontradikte me kuptimin e kësaj feste, kjo që praktikojmë ne. Besoj se shumica e njerëzve nuk e dinë më fare kuptimin e dhuratave. Krishtlindja, për mua si famullitar është thjesht një shans, për t'ua kujtuar njerëzve këto gjëra"./Dw

Steven Tyler zbulon zemërimin mes anëtarëve të "Aerosmith"

Steven Tyler ka zbuluar se i ka kaluar "shumë vjet" duke qenë i zemëruar në shokët e tij të bendit "Aerosmith" për shkak se e kishin dërguar në rehabilitim në vitet '80 - megjithëse ai më vonë ishte "mirënjohës" për vendimin e tyre. Ai gjithashtu pohoi se disave prej drejtuesve të afërt me bendin në të kaluarën u pëlqente fakti që shumica prej tyre ishin shumë të dehur që të bëjnë pyetje në lidhje me financat e tyre. "Aerosmith nga viti '72 deri në '79 nuk ishin të droguar... Por pastaj të gjithë u bëmë shumë të droguar", tha Tyler për Haute Living në një intervistë të fundit. "Nuk kishte gjëra si rehabilitimi; kishte institucione mendore. Unë u largova në '84 dhe '86 dhe nuk e kuptova situatën. Fillimi i viteve '80 ishte i tmerrshëm dhe droga na tërhoqi poshtë. Unë kam qenë i pari që u trajtova." Ai vazhdoi: "Ishte një moment në vitin '88 kur menaxhmenti dhe

bendi kërkuan intervenim tek unë. Ata menduan: "Ta shërojmë këngëtarin kryesor dhe të gjitha problemet tona do të kenë mbaruar." Kështu që e tejkalova varësinë dhe m'u deshën shumë vjet për ta kapërcyer zemërimin ndaj tyre që më dërguan në rehabilitim, ndërsa ata shkuan me pushime. Por sot, për atë moment... u jam mirënjohës dhe duhet t'u falënderohem për rehabilitimin tim." Këngëtarit tha se kur u pyet për varësinë nga heroina, ai u përgjigj: "Po, por kjo nuk është asgjë në krahasim me faktin kur bendi i shkruan këngët e tyre, i interpreton dhe i dëgjon në një studio regjistrimi në altoparlantët që janë shumë të mëdhenj. Më pas, jeni në radio... Nuk ka drogë më të fortë se muzika." Tyler vazhdoi duke thënë se Aerosmith "kurrë nuk e kishte thënë të vërtetën" për përvojat e tyre negative në biznesin e muzikës. "A doni të futeni në të?



Apo doni që njerëzit thjesht ta duan atë album?", reflektoi ai, përcjell KOHA Ditore. "A dëshironi ta bëni atë album të madh, apo dëshironi që njerëzit ta dinë atë që ju nuk e dinit sepse ishit nën ndikim të drogës, dhe

menaxherët tuaj dhe etiketat muzikore e pëlqenin këtë tek ju?" Ai vazhdoi: "Atyre u pëlqente kjo për bendin. Menaxherëve tanë të parë u pëlqente që ishim të droguar. Shtëpia jonë muzikore atyre u pëlqente që ishim të

droguar, sepse e dinin që nuk i shikojmë transaksionet e parave. Dhe a nuk ka qenë kështu gjithmonë... Kjo anë e biznesit të muzikës që është thjesht një rrugë e errët dhe e ndyrë e gënjeshtrove dhe e avokatëve."

E jashtëzakonshme

Piktura që u gjet e varur në kuzhinë kap vlerën 24 milionë euro

Zbulimi i një pikturë të shekullit 13 të artistit të famshëm Cimabue në kuzhinën e një gruaje në Francën veriore mahniti botën e artit dhe qeveria vendosi ta klasifikojë si një thesar kombëtar. E gjetur në muajin shtator, piktura u shit në ankand një muaj më vonë për 24 milionë euro. Vepra e artit, vetëm 20.3 cm e gjatë dhe 28.5 cm



e gjerë, u vu re nga një drejtuese ankandi gjatë një vizite në banesën e një gruaje të moshuar pranë qytetit të Compiègnes.

FOTO E DITES



Një burrë në Kabul shihet duke transportuar enë plastike. /AFP/

E rrallë

Pistoleta "Kalashnikov" që kërkon të bëhet aq e famshme sa automatiku

Ushtria ruse ka vendosur ta ndryshojë pistoletën standarde të ushtarëve, të njohur me emrin "Makarov". Kjo ka bërë që prodhuesit e armëve të hidhen në garë. Cili do ta krijojë pistoletën që do t'i mbajnë ushtarët rusë në të ardhmen? Pretendenti kryesor duket "Kalashnikov Concern", me pistoletën PL-15 K. Po çfarë ka të



veçantë kjo armë? Përdoruesit thonë se në dorë ndihet sikur po mban një i-Phone. Ndihet më mirë dhe më lehtë se çdo armë tjetër. Është shumë e thjeshtë për t'u përdorur nga çdo person, pavarësisht përvojës.

BARSOLETA E DITËS

Njëri që deshi të bëhej polic ndoqi një kurs të cilin e drejtonin të huajt. Kur kishin testin përfundimtar, atë e pyetën:
- Nëse e shihni një hajdut duke vjedhur në një dyqan, çfarë bëni?
Kandidati:
- E thërras policinë së më parë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min
Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.
Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan

Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min
Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.
Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee

Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min
Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.
Regjia: James Mangold

Çdo natë në ora 21:30

TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min
Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.
Regjia: Tim Miller

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Një qortim apo një problem i vogël ligjor do t'ju bëjë më të matur dhe më të mençur ditën e sotme. Ju mund të përballeni me disa telashe, prandaj është koha që të bëni një hap prapa dhe të merrni frymë thellë.</p>	 <p>DEMI Ekziston një ndjenjë e fortë e miqësisë midis jush dhe disa moshatarëve tuaj ditën e sot. Ky mund të jetë një mjet shumë i fuqishëm për ju. Ju dhe miqësia e ngushtë mund të kenë një ndikim të madh në të realizuarin e gjërave.</p>	 <p>BINJAKËT Inteligjenca e vërtetë nuk do të thotë se duhet të dini gjithçka, por të jeni të vetëdijshëm se ju nuk dini gjithçka. Për fat të mirë, egoja juaj është mjaft e shëndetshme dhe mund ta pranoni këtë. Jini të hapur për të mësuar gjëra të reja që nuk i keni parë apo dëgjuar më parë.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk ka nevojë të jesh paranojak, por duhet patjetër të kesh kujdes me disa persona në jetën tuaj. Ata mund të ndiejnë shumë stres dhe mund ta kenë të vështirë të kuptojnë se cili është vendi juaj në jetën e tyre.</p>	 <p>LUANI Nëse një prej përbërësve thelbësorë të një projekt i juaj mungon, mos harxhoni kohë duke e kërkuar. Nëse përqipeni të gjeni një rrugëzgjdhje ditën e sotme, do të përfundoni të zhgënjyer dhe shumë në siklet.</p>	 <p>VIRGJËRESHJA Një qortim do të nxisë debate ditën e sotme dhe ju do të përqipeni ta shpjegoni dhe tregoni qëndrimin tuaj. Të kesh një diskutim të thellë me dikë tjetër është një mënyrë e shkëlqyeshme për të përcaktuar se kush je dhe për t'ua treguar të gjithëve.</p>
 <p>PESHORJA Çdo gjë e vogël që bëni sot do të jetë magjike, prandaj sigurohuni që të dukeni më të mirët kur jeni në sytë e publikut. Investimi në disa roba të reja mund të mos jetë një ide e keqe.</p>	 <p>AKREPI Ju keni një durim të admirueshëm, por dikush do ta provokojë atë sot. Një person do t'ju lodhë dhe do t'ju sositë durimi duke ju kërkuar sërish të shtyni pak më shumë kohën për ta shlyer borxhin që ju ka.</p>	 <p>SHIGJETARI Bërija e disa zgjedhjeve do të jetë shumë e këndshme për ju tani, kështu që reflektoni për opsionet tuaja dhe vlerësojini ato si me kokë ashtu edhe me zemër.</p>	 <p>BRICJAPI Por kjo mund të krijojë gjithashtu shumë ide tërheqëse që rrisin kreativitetin tuaj dhe ju motivojnë të bëni një ndryshim të rëndësishëm që keni menduar.</p>	 <p>UJORI Do të përfshihen në një takim me njerëz shumë të ndryshëm ditën e sotme. Kjo përplasje kulturore mund të shkaktojë stres midis jush dhe dikujt që nuk komunikon shumë mirë.</p>	 <p>PESHQIT Hapni një film apo luani ndonjë lojë me shokun tuaj në shtëpi. Shijoni jetën dhe ndaloni së shqetësuar për gjërat nuk po i bëni tani.</p>

Mbretëresha uron Krishtlindjen, mbi tryezë mungojnë fotot e Princ Harryit dhe Meghanit



Mbreteresha Elisabeth ka uruar edhe këtë vit Krishtlindjet. Duke iu drejtuar qytetarëve, ajo ka folur për vështirësitë që ka pasur ky vit. Ndër të tjera, Mbretëresha tha se me 'hapa të vegjël' mund t'i kapërcejnë vështirësitë pa vitit të trazuar për familjen Mbretërore dhe kombin. "Rruga, natyrisht, nuk është

gjithmonë e qetë, dhe ndonjëherë mund të jetë ndier herë pas here këtë vit, por hapa të vegjël mund të bëjnë një botë ndryshimesh", ka thënë mbretëresha Elisabeth. Ajo që u vu re në tavolinën e mbretëreshës Elisabeth ishte mungesa e fotos së Meghanit dhe Harryt. Këtë vit Meghan dhe Harry do ta kalojnë festën e Krishtlindjeve larg familjes mbretërore.

Irina Shayk plot buzëqeshje e shoqëruar nga vajza



Ajo është një nga super-modelueset më të kërkuara në botë, por Irina Shayk nuk hezitoi t'i japë publikut një paraqitje të shkurtër të stilit të saj ndërsa po ndante kohë me vajzën trevjeçare Lea de Seine Cooper. Shayk këtë herë u pa në një palë tuta ngjyrë blu. Për pak kohë ajo ishte kapur nga syri i fotografit në çaste përplot lumturi. Shijes ajo i kishte shtuar edhe një palë çizme të stilit ushtarak.



Rita Ora feston Krishtlindjen në një jaht dhe shfaqet me bikini

'Pushimet fillojnë tani, 2019 ka qenë një vit shumë i ngjeshur'. Kështu komenton Rita Ora në disa fotografi të ndara në rrjetet sociale ku tregon format me bikini dhe rendit sukseset e koleksionuara në vitin që po mbaron: "Një film, një turne botëror, show

televiziv, fushatat publicitare, kopertinat e revistave, katër video muzikore, një çmim AMA... etj. Jeni gati për 2020-n", vazhdon këngëtarja me origjinë shqiptare, që ndodhet në S. Barths për t'i kaluar pushimet e krishtlindjes me familjen.

Cardi B "shokon" pa grimë




Cardi B është një nga reperet më seksi në botë dhe duket se grimi luan një rol të rëndësishëm në "look-un" e saj. Ylli i hip-hop ka "shokuar" fansat pasi është fotografuar pa make-up duke bërë blerë në një qendër tregtare në Miami. Cardi dukej ndryshe nga ç'jemi mësuar ta shohim, megjithatë vëmendjen arriti ta tërhiqte sërish mes turmave.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Fetahu: Viti 2019, i jashtëzakonshëm për basketbollin

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Viti 2019 ka qenë me shumë aktivitete për basketbollin e Kosovës. Pjesëmarrja me gjashtë ekipet e reja: Kosova U20, U18 dhe U16 në të dyja konkurrencat, organizimi i Evropianit i Divizionit B për Femra U20, ndeshjet e Kosovës A, garat vendore dhe për gjeneratat e reja, kanë qenë disa nga aktivitetet që e kanë përcjellë Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) gjatë vitit që po e lëmë pas. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ka folur për të arriturat në vitin 2019.

Si ka qenë viti 2019 për basketbollin e Kosovës?

Fetahu: Pa dyshim se e arritura më e madhe ka qenë organizimi i jashtëzakonshëm i Kampionatit Evropian, Divizioni B, për Femra U20 në Prishtinë. Ka qenë hera e parë që një Evropian i Divizionit B është mbajtur në vendin tonë. Për organizimin e mirë kemi marrë lëvdata edhe nga FIBA. Ka qenë një përvojë shumë e mirë për ne. Në përgjithësi me kategori të reja kemi marrë pjesë në gjashtë Kampionate Evropiane, të gjitha në Divizionin B. Këtë vit për herë të parë kemi Superligën e Femrave me gjashtë skuadra, derisa gjashtë skuadra të tjera janë në Ligën e Parë të Femrave. Po ashtu, u kemi kushtuar shumë rëndësi gjeneratave të reja dhe tashmë kemi liga deri në U12, ku

në këtë vit kemi filluar për herë të parë edhe me femrat U14. Janë organizuar kampe të suksesshme për U14 në konkurrencën e meshkujve dhe atë të femrave. Gjithashtu janë organizuar edhe seminare për trajnerë dhe gjyqtarë. Tashmë kemi gjashtë gjyqtarë që gjykojnë në garat evropiane. Sigal Prishtina te meshkujt arriti për herë të parë të jetë në Top-16 të FIBA Europe Cup. Ky ishte një sukses i madh. Edhe Klubi i Rahovecit për herë të parë ka marrë pjesë në kualifikimet e FIBA Europe Cup dhe po garon në Ligën Ballkanike. Mabetex Prishtina në konkurrencën e femrave për herë të parë ka garuar në FIBA EuroCupWomen. Në përgjithësi ka qenë hera e parë që një skuadër e Kosovës garon në gara të nivelit të tillë. Shpresojmë se në edicionet e ardhshme do të kemi më shumë suksese në këtë garë. Edhe në këtë vit kemi ndihmuar klubet, duke i hequr obligimet financiare për gjyqtarët dhe mbajtjen e statistikave 'Live'.

Cilat kanë qenë sfidat për këtë vit?

Fetahu: Kemi pasur shumë aktivitete dhe sigurisht se nuk kanë munguar edhe sfidat. Kemi investuar edhe në infrastrukturë sa kemi mundur, në mënyrë që garat ndërkombëtare të zhvillohen normalisht dhe pa asnjë problem, por sigurisht se ka



nevojë për më shumë. Për këtë kërkoj ndihmën nga institucionet qendrore. Shpresoj se do të kemi më shumë ndihmë nga shteti, sepse po organizojmë shumë ngjarje, siç është Evropiani në Prishtinë, seminare me trajnerë e gjyqtarë, kampe për grupmosha të reja dhe shumë aktivitete të tjera. Gjithashtu, në këtë edicion është rikthyer KB Peja, që i ka munguar basketbollit të Kosovës. Kjo ka shtuar interesimin në Superligë, rivalitetin, por edhe shikueshmërinë.

Çka e pret basketbollin e Kosovës më 2020?

Fetahu: Ngjarja më e madhe pa

dyshim se do të jetë organizimi i Evropianit i Divizionit C për Meshkuj U16 në Prishtinë. Kjo është hera e tretë radhazi që FIBA Evropa na beson një Kampionat Evropian të zhvillohet në Prishtinë. Kjo do të thotë shumë për FBK-në, por edhe një shpërbllim për punën që ka bërë në organizimin e dy kampionateve në kryeqytet, që kanë qenë shembull edhe vendet e tjera. Një projekt shumë i madh dhe që presim të realizohet është Qendra Kombëtare e Basketbollit (QKB). Pasi jemi takuar me Grupet e Interesit siç janë trajnerët, klubet dhe veteranët, presim që projekti të realizohet, si dhe

Themelimi i Veprimtarisë së Akademive të Basketbollit në Kosovë. Këto janë shumë të rëndësishme për gjeneratat e reja dhe besojmë se mund të kenë suksese, derisa nga kjo do të përfitojnë gjeneratat e reja të basketbollit, por edhe të kemi më shumë rezultate pozitive në garat ndërkombëtare. Gjithashtu presim që Kupa të organizohet në mënyrë më të mirë të mundshme, si dhe garat vendore të shkojnë në mënyrë më të mirë të mundshme. Shpresojmë se do të kemi suksese edhe me Kosovën A, gjeneratat e reja, si dhe me skuadrat tona në garat ndërkombëtare.

Challandesi fton 13 lojtarë nga Superliga



PRISHTINË, 24 DHJETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e ka bërë publike listën e futbollistëve për ndeshjen miqësore kundër Suedisë. Kjo ndeshje zhvillohet më 12 janar në Doha të Katarit. Ndryshe nga e kaluara, për këtë ndeshje trajneri Challandes ka ftuar 13 futbollistë që angazhohen në klubet e IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Rron Broja është ftuar nga skuadra e

Partizanit dhe Leart Sadiu nga Shkëndija e Tetovës. Nga lojtarët që kanë qenë pjesë e Kosovës edhe në ndeshjet kualifikuese janë ftuar Anel Rashkaj, Fidan

Aliti, Herolind Shala, Elbasan Rashani dhe Visar Bekaj. Ky i fundit do ta ketë mundësinë që të jetë portier i parë në këtë ndeshje.

LISTA E FUTBOLLISTËVE:

Visar Bekaj, Florian Smakiqi, Fidan Aliti, Leotrim Bekteshi, Lapidar Lladrovci, Lirim Kastrati, Armend Thaqi, Leart Sadiu, Edison Kqiku, Albin Krasniqi, Ismet Lushaku, Albert Dabiqaj, Herolind Shala, Anel Rashkaj, Florian Loshaj, Rron Broja, Zymer Bytyqi, Elbasan Rashani, Arbër Hoxha, Valimr Veliu, Jetmir Topalli, Ylldren Ibrahim, Blend Baftiu, Arb Manaj, Flamur Kastrati.

Manaj: Kam oferta nga vendet e Ballkanit, klubi vendos për mua

MITROVICË, 24 DHJETOR - Viti 2019 ishte i jashtëzakonshëm për sulmuesin perspektiv të Trepçës '89, Arb Manaj. Golat e realizuara në gjysmën e parë të edicionit 2019/20 kanë bërë që në adresë të

Manajt të mbërrijnë oferta të ndryshme. Duke u shprehur shumë i lumtur që ishte pjesë e formacionit të vitit në Superligë, Manaj foli edhe për të ardhmen. "Ka oferta shumë, mirëpo kam kontratë

me Trepçën '89 dhe duhet ta respektoj. Të ardhmes nuk i dihet, mirëpo '89-shi është klubi që më ka kthyer në futboll dhe më ka shëruar, andaj çdo vendim që e merr klubi për shitjen apo qëndrimin

tim, e respektoj në maksimum", ka thënë Manaj për "Olle". "Emra skuadrash nuk mund të jap, mirëpo kam pasur edhe oferta jashtë shtetit, kryesisht në Ballkan", ka shtuar Manaj.



Berisha në mesin e 20 lojtarëve më të mirë në Serinë A

FERRARA, 24 DHJETOR - Etrit Berisha bëri një lëvizje në afatin kalimtar të verës duke u larguar nga Atalanta për të firmosur me SPAL-in. Gardiani i Kombëtares

shqiptare është kthyer te SPAL-i një nga më të rëndësishmit e skuadrës dhe po përpiqet ta ndihmojë ekipin për të mbijetuar e shpeshherë ka marrë vlerësime

maksimale për paraqitjet e bëra dhe pritjet e shumta. Këto paraqitje kanë bërë që Berisha të përfshihet në mesin e 20 futbollistëve më të mirë të kampionatit.

Natyrisht se ky është një vlerësim i madh për portierin që e mbyll këtë dekadë me më të mirëve të kampionatit, duke qenë ndër më të dalluarit në fushë.



Dajaku, e ardhmja e Bayernit

MÜNCHEN, 24 DHJETOR - Leon Dajaku po konsiderohet e ardhmja e Bayern Munchenit. Për yllin e ri shqiptar ka shkruar së fundmi mediumi i madh gjerman, "Bild". 18-vjeçari i ishte bashkuar gjigantit "bavarez" nga Stuttgarti, kurse ai i ka zhvilluar tri ndeshje në Bundesligë deri tash. Ai e kishte bërë debutimin me Stuttgartin në dhjetor të vitit 2018 kur ishte 17-vjeç. "Mendoj se kishte tifozë që do të donin të më shihnin mua duke luajtur gjithmonë me profesionistët. Ata dëshironin lojtarë të freskët, lojtarë të rinj", ka thënë Dajaku për "Bild".

Në Bayern, mesfushori ofensiv u bë pjesë e stërvitjeve të ekipit të parë prej mesit të nëntorit, pasi trajneri Hans Flick beson në aftësitë dhe potencialin e tij. "Ishte ndjenjë e çuditshme para seancës së parë stërvitore. Papritmas afër meje ishte Robert Lewandowski, të cilin e njihja vetëm përmes televizorit. Pastaj Joshua Kimmich e Serge Gnabry, të cilët më ndihmuan shumë", ka shtuar ai. Në dhomat e zhveshjes ai ulet afër Thomas Mullerit, një tjetër yll i



gigantit "bavarez". "Nëse do të qëndroj aty, do të bëhem lojtar i madh", shton Dajaku duke buzëqeshur. Të shtunën që shkoi ai e bëri debutimin me Bayernin në Bundesligë në duel me

Wolfsburgun. "Nëse nuk beson se je mjaftueshëm i mirë, nuk mund të shkosh në Bavari. Prandaj, nuk ka arsye të mos kem vetëbesim", përfundoi Dajaku, i cili në lojën e tij e ka model Cristiano Ronaldon.

Houstoni triumfon ndaj Sacramentos, Toronto ndalet në shtesë nga Indiana

SACRAMENTO, 24 DHJETOR - Skuadra e Houstonit triumfoi me rezultat 113-104 në fushën e Sacramentos, duke u ngjitur në vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit. Ekipi tek-san dominoi dhe fitoi me meritë, me dyshen Harden-Westbrook, që së bashku realizuan 62 pikë. Fitore të lehtë korri San Antonio, që mundi 145-115 Memphisin, ndeshje e komanduar nga skuadra e Spursit. Aldridge me 40 pikë dhe DeRozan me 26 pikë e 10 asistime ishin më të mirët në fushë për skuadrën e San Antonios. Rikthehet te fitorja skuadra nënkampione e Golden State, që e mposhti me rezultat 113-104 Minnesotan, një



nga mbrëmjet e pakta pozitive për Warriorsin këtë sezon. Russell me 30 pikë dhe Burksi me 25 bënë diferencën në parket për Golden State. Mes skuadrave më të mira në Perëndim është edhe Denveri, që sot fitoi me rezultat 113-111 ndaj Phoenixit, ndeshje me rivalitet deri në fund (Murray 28 pikë). Nikola Jokiqi realizoi një "Triple double", me 22 pikë, 12 rebounde e 10 asistime, raporton

"Telesport". Në Lindje, kampionët e Torontos u mundën me rezultat 120-115 nga Indiana pas kohës shtesë, sfidë e fortë deri në fund. 30 pikët e Lowryt për kanadazët mbetën për statistikë, ndërsa për Indianan u dalluan Warreni e Turner, me nga 24 pikë secili. Pas 5 fitoresh radhazi ndalet skuadra e Utah Jazzit, që u mund 107-104 nga Miami, sfidë ku u dallua Jimmy Butler, autor i 20 pikëve.

SHKURT

Arteta nuk llogaritet në Mustafin, e ardhmja në Itali

Qendërmbrojtësi i Arsenalit dhe Gjermanisë, Shkodran Mustafi, mund të kthehet në Itali. Mediat raportojnë se 27-vjeçari është vënë nën shënjestrën e Bolognas, e cila synon që në 2020 t'i përmirësojë rezultatet në kampionatin italian. Mustafi thuhet nuk bën pjesë në radhët e "topçinjve". Edhe pas emërimit të Mikel Artetës në stolin e skuadrës londineze duken të pakta shanset që Mustafi ta rifitojë sërish besimin e drejtuesve të stafit teknik. Sipas "Tuttomercatoweb", ish-kampioni i botës me Gjermaninë në vitin 2014 mund të kalojë te Bolonja në formë huazimi, plus opsionin e blerjes në fund të sezonit. Ky është sezoni i katërt i Mustafit në Londër, ndërsa është kritikuar prej që së bashku janë me Granit Xhakën dhe Mesut Ozilin nga tifozët e Arsenalit. Ai ka luajtur më parë në Itali me Sampdorian në sezonet 2012-2014.

Ofertë interesante e Juves për Pogban

Kampioni i Italisë, Juventus, është duke tentuar ta bëjë rikthimin e Paul Pogbas në Torino. Lajmi është bërë me dije nga "Tuttosport". Drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" i kanë ofruar Manchester Unitedit 60 milionë euro dhe kartonin e mesfushorit Emre Can për të bindur që të heqin dorë shërbimet e Pogbas. Unitedi besohet se është gati të negociojë për mesfushorin e tyre, i cili ka kontratë edhe 18 muaj dhe nuk dëshiron ta lejojë që të largohet me parametra zero.

Tebas rizgjidhet president i La Ligës


Javier Tebas është rizgjedhur zyrtarisht president i La Ligës për një mandat të ri katërvjeçar. Ky do të jetë mandati i tretë radhazi i Tebas si i pari i ligës elitare të futbollit në Spanjë. Asnjë kandidat nuk garoi për këtë post, prandaj komisioni zgjedhor e riemëroi 57-vjeçarin në postin e presidentit të La Ligës. Mandati i Tebas pritej të përfundonte më 10 tetor të vitit 2020, por ai u regjistrua në mënyrë që të garonte përsëri për president. Afati për dorëzimin e kandidaturave për president u krye më 16 dhjetor dhe Tebas ishte kandidati i vetëm i paraqitur në komision.

Milani ndryshon kushtet për Ibrahimoviqin

Zlatan Ibrahimoviqi është më afër se kurrë kthimit te Milani pas raporteve se zgjatja e kontratës nuk do të varet nga kualifikimi në Evropë, por nga performanca e tij. Sulmuesi veteran është një lojtar i lirë pasi marrëveshja e tij me LA Galaxy skadoi. Bisedimet ishin ndërprerë javën e kaluar, por duket se kanë rifilluar me një përparim të rëndësishëm. Sipas dy gazetave "La Gazzetta dello Sport" dhe "Corriere della Sera", do të jetë një kontratë gjashtëmujore, me mundësi zgjatje automatikisht për një sezon më shumë. Për dallim nga plani fillestar për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve apo Ligën e Evropës, propozimi i ri do të bënte që Zlatan të marrë 18 muaj të plotë bazuar në performancat e tij dhe statistikat e golave. Milani shpreson se do të marrë një vendim gjatë ditëve në vijim dhe ai mund të jetë në terrenin e trajnimit nga 30 dhjetori.

REZULTATET

Cleveland - Atlanta	121-118
Detroit - Philadelphia	109-125
Indiana - Toronto	120-115
New York - Washington	115-121
New York - Washington	115-121
Orlando - Chicago	103-95
Miami - Utah Jazz	107-104
Memphis - San Antonio	115-145
Phoenix - Denver	111-113
Portland - New Orleans	94-102
Sacramento - Houston	104-113
Golden State - Minnesota	113-104



EPOKA E RE		Autor: GAZMEND MORINA		FUTBOLLISTI NË FOTO (shqip.)	KËNGËTARE E FAMSHME BRITANIKE	SHKRIMTARI KUKAJ	ZBRITJA E AEROPLANIT NË TOKË	SHEGA	BASHKËT.	IDRIZ SEFERI	ISH POLITIKANI BRITANIK ROBIN ... VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE (sh.shq.)	DAMARI I GJAKUT	NJË PLANET (shq.)	MODERATORI BENET
SIGURI E CILA I JEPET DIKUJT PËR NJË TË DREJTË QË I TAKON														
KËNGËTARJA SOPJANI									GRILLI ZANORE					
ARBITRI										LLOJ HELIKOPTERI SHTET (fr.)				
BARI PELASH (shq.) VITI I RI KINEZ										KËNGËTARJA ADELINA ISMET TOTO				
BASKETBOLLISTI LUCA										SHTET NË EVROPË (pashq.) SHUMË I MADH, GOXHA (krah.)				REPER AMERIKAN
BASHKËT.					PORTIERI SPANJOLL PEPE		ENË TENEQEJE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT DY BASHKË.							ZANORE INSTITUTE PUBLIC ACCOUNTANTS
EPOKA E RE		PLAK I RRËGJUAR NGA MENDTË	SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË	SHKRIMTARJA KAMBERI	FRYMA	"RISANI"	AKTORI I FAMSHËM ... LI "ASHTU QOFTË" (mysl.)			ANNA LEE ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL (shqip - shq.)		LLOJI, SOJI MJET SHPËRTHYES		
LËNDË JOORGANIKE QË GJENDET NË KOREN E TOKËS (shq.)								VAJ KUZHINE QË PRODHOHET NË SHQIPËRI AKTORJA CAHANI				AJKA E QUMËSHTIT	KYÇ I TAKOJ	
ANËTARËSIM NË NJË PARTI POLITIKE								RRAFSHIM ISH FUTBOLLISTI ÇEK JANKULOVSKI (MILAN)						EVERTON I EMËRUAR
AKTORJA E NJOHUR REID							KUZHINË PRANË XHAMISË RRËMUJË				EMËR MASHKULLI TURK FAREFIS (bised.)			
NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË					KËNGËTARJA ... OKSA NËNA			ESTONIA, NORVEGJIA I KËTJË ÇASTI, I KËSAJ KOHE		SHPEND I EGËR, ME TRUP SA TË GJELIT KLUB FUTB. NË ITALI				POETJA AHMETI
KUNDREJT MASHKULL							BËRJA MË I RI SHIU I IMËT				GRIMCË MOLEKULARE E SHOQJA E AGAIT			
EPOKA E RE		AI QË BËN DEMAGOGJI	BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.) SIMBOL I FESË MYSLIMANE						REGJISORI QOSJA KULAÇE				EMINE (perkdh.) AGIM TEJECI	
PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVI-ZJES SË TRUPAVE								ILION LIKA ZANORE			GATESË BANORE E NJË SHTETI SKANDINAV			
"M" në mes të dy "E"					AZEM GALICA QYTET NË KOSOVË			SHTEGTARET PËRFUNDIM NË SHAH					JO (ang.) BASHKËT.	
MARK ANTONI				LLOJ PESHKU (shq.) KRYEHOXHA				NË ANË, NË BRINJË TË DIÇKAJE PASURIA E PATUNDSHME (vjet.)					QYTEZË SHQIPTARË NË MAL TË ZI POPULL (turq.)	
KËNGËTARJA MIMANI							DASHNOR (turq.) THIRRJE E MYEZINIT			ZULMË FORTESE			ALI ALIU GËZIM I MADH	
BASHKËT.			BREJTËS I VOGËL KRAHINË NË SHQIPËRI			BABALLARË ZANORE			"KENIA" RENUIM, ZET		INSTITUTE HISTORICAL RESEARCH			NUK KA (bised.)
BANOR I NJË SHTETI AZIATIK							SMIRË JEMENI, ANGOLA				NOTË MUZIKORE DY BASHKËTINGËLLORE			BASHKËT. ISMET MUNISHI
SHKRONJË GREKE ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI						ADEM JASHARI ZANORE		MJET PËR BARTJE NË VISE MALORE BASHKËT.						
K					METODË STUDIMI					EMBLEMA				

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "HIDRIA" L.L.C, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 70626799 me nr. fis. 600384333 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "HIDRIA" L.L.C, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70626799 fis. 600384333 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "HIDRIA" L.L.C, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70626799. fis. 600384333 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Magbule Alshiqi shpall të pavlefshme INDEX-in, e fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qeshori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistratja Prishtinë-Besianë. Truallin ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,
 Ministri of Education, Science and Technology*

Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 4 i Udhëzimit administrativ 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe kërkesave të Qendrave Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, rishpall dhe shpall;

KONKURS

Për vende të lira të punës në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim

- I. Një (1) mësues/e klase në sh. speciale "Shpresa" në Shtime - (i rishpallur)
- II. Dy motra konviktore në konvikt një (1) në QB "Xheladin Deda" në Pejë dhe (1) motër konviktore në QB "Lef Nosi" në Prizren
- III. Një (1) servues/e në kuzhinë në QB "Lef Nosi" në Prizren

I. Punët dhe detyrat e mësuesit/es së klasës

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit fillor;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdorë metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Udhëheq klasën dhe bashkëpunon me asistentin në klasë;
- Harton plane individuale për nxënës;
- Bashkëpunon ngushtë me ekipin vlerësues pedagogjik;
- Zhvillon dhe inicion planin për përcjelljen e nxënësit në klasa të rregullta;
- Mban dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike të shkollës mbi punën arsimore - edukative të nxënësve.

Përgatitja shkollore e mësuesit/es së klasës

- Fakulteti i Edukimit- programi i arsimit fillor;
- Fakulteti i mësuesisë.

II. Punët dhe detyrat e motrës konviktore

- Identifikon nxënësit në aspektin shëndetësor dhe në rast nevojë bën rekomandim për në institucionet shëndetësore;
- Përcjell gjendjen shëndetësore të nxënësve brenda qendrës burimore
- Jep terapinë mjekësore nxënësve sipas diagnozës dhe rekomandimit të mjekut;
- Ndërmerr masa preventive dhe sanitare në lidhje me pastërtinë e nxënësve (kontrollimi i flokëve, pastërtinë e përgjithshme, nevoja fiziologjike etj.);
- Mban evidencë për shërbimet shëndetësore që iu ofron nxënësve;
- Këshillon nxënësit individualisht dhe në grup për shëndetin dhe higjienën;
- Shoqëron nxënësit në kohën e ushqimit dhe kujdeset gjatë kohës së ushqimit;
- Bën raporte javore dhe mujore për shërbimet e ofruara nxënësve të qendrës burimore;
- Kujdestaron në Qendër edhe gjatë pushimeve, vikendeve dhe festave.

Përgatitja shkollore e motrës konviktore

- Shkolla e mesme e mjekësisë

III. Punët dhe detyrat e servuesit/es

- E bënë servimin e ushqimit në sallën e ushqimit (mëngjesit, drekës dhe darkës);
- Është përgjegjës për pastërtinë e hapësirës së kuzhinës;
- Pastron inventarin e hapësirës së kuzhinës;
- Bënë hedhjen mbeturinave të kuzhinës në deponi të caktuar të qendrës;
- Pastron enët dhe mjete tjera të ushqimit;
- kryen dhe punë tjera që i cakton drejtori.

Përgatitja shkollore për servues/e në kuzhinë

- Shkolla e mesme

Dëshmi shtesë për fazën e paraseleksionimit

Certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT, gjegjësisht vetëm ato që konsiderohen relevante për vendin e punës sipas konkursit. Për pozitën mësuese klase përvojë pune një vjeçare në arsim.

Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Udhëzimit administrativ nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Sqarim shtesë: - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT.

- Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit. Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës. Për të gjitha pozitave periudha provuese e punës është 1 (një) vit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit (merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar.

Dëshmi që nuk është nën hetime.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Lumë's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauka i Tehnologije -
 Ministry of Education, Science and Technology*

Na osnovu zakona o radu br. 03/L-212, Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04/L-032 član 4 i Administrativno uputstvo 10/2018 o Normativima profesionalnog kadra opšteg obrazovanja, Administrativno uputstvo br. 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 07/2017 o regulisanju procedure konkursa u javnom sektoru i zahtevima Resursnih centara, Departamenta preduniverzitetskog obrazovanja ponavlja i objavljuje

KONKURS

Za slobodna radna mesta u Resursnim centrima za nastavu i savetovanje

- IV. *Jedna (1) učitelj/ca specijalne škole "Shpresa" u Štimlje - (ponovljeni)*
- V. *Dve sestre u domu u dob jedna (1) u RC "Xheadin Deda" Peć i jedna (1) sestra u domu u RC "Lef Nosi" u Prizren*
- VI. *Jedan (1) za serviranje u kuhinji RC "Lef Nosi" u Prizren*

II. Zadaci i obaveze razrednog učitelja/ce

- Ispunjava ciljeve i obaveze osnovnog obrazovanja i vaspitanja;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Rukovodi razredom i saraduje sa asistentima u razred
- Sastavlja individualne planove za učenike;
- Blisko suraduje sa ekipom za pedagoško ocjenjivanje;
- razvija i inicira plan za praćenje učenika u redovnim razredima;
- Vodi dokumentaciju i pedagoške evidenciju škole o edukativno-obrazovnom radu učenika;

Školska sprema razrednog/e učitelja/ce

- Edukativni fakultet - program osnovno obrazovanje;
- Učiteljski fakultet.

II. Zadaci i obaveze sestre vaspitačice u domu

- Identifikuje učenike sa aspekta zdravlja i prema potrebi daje preporuke zdravstvenim ustanovama;
- Prati zdravstveno stanje učenika unutar resursnog centra
- Daje medicinsku terapiju učenicima prema dijagnozi i preporuci lekara;
- Poduzima preventivne i sanitarne mere u vezi čistoće učenika (kontrola kose, opšta higijena, fiziološke potrebe itd.);
- Voditi evidenciju o zdravstvenim uslugama koje se nude učenicima;
- Savetuje učenike pojedinačno i u grupama o zdravlju i higijeni;
- Prati učenike u vreme obroka i stara se o njima za vreme obroka;
- Sastavlja nedeljne i mesečne izveštaje o uslugama omogućenih učenicima Resursnog centra;
- Dežura u Centru tokom odmora, vikenda i praznika

Školska sprema sestre vaspitačice u domu

- Srednja medicinska škola

III. Zadaci i obaveze sestre vaspitačice u/ce

- Vršiti serviranje hrane u sali za ručavanje (doručak, ručak i večera);
- Odgovoran je za higijenu u kuhinji;
- Čisti inventar u kuhinji
- Izbacuje smeće iz kuhinje na određenoj deponiji;
- Pere suđe i ostale alate u kuhinji;
- vrši i druge poslove koje mu odredi direktor

Školska sprema osobe koja servira u kuhinji

- Srednja škola

Dodatni dokaz za pred kvalifikacionu fazu

Certifikat o treninzima akreditovanih od strane MONT-a, odnosno samo one koje se smatraju relevantnim za radno mesto prema konkursu. Za poziciju razredni učitelj radno iskustvo od jedne godine u obrazovanje.

Uslovi konkursa

Izbor kandidata vrši se na osnovu kriterijima Zakone koji regulišu oblast obrazovanja: Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, br. 04/L-032, Administrativno uputstvo br. 10/2018 o normativu profesionalnog kadra za opte obrazovanje.

Dodatno obrazloženje: - Podaci navedeni u aplikaciji smatraju se validnim samo ako su potkrepljeni dokumentima - Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati dokumenta nostrifikovana u MONT.

- Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa. Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo. Za sve pozicije probni radni staž je 1 (jedna) godina.

Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.

Formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resornom Centru).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili sertifikat) sertifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Dokaz da nije pod istragu

Kandidati, dokumenta trebaju predati u relevantni Resursni centar / Specijalnu školu u kojoj konkurišu. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
 REGIONAL WASTE COMPANY
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588

+381(0)390/324 034

www.cabrati.com

e-mail. info@cabrati.com

Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

NJOFTIM

1. Me cilin Konkursi i Publikuar me datën 24.12.2019 për pozitën ARKËTAR/E, për shkaqe praktike pëson ndryshim-përmirësim në pjesën e tekstit të kushteve dhe dokumentacionit të kërkuara dhe atë:

- përgatitja profesionale, dhe
- përvoja e punës.

Pjesët tjera mbesin të pa ndryshuara.

2. Tekstin e ndryshuar- përmirësuar mund ta gjeni në web faqen e ndërmarrjes w.w.w. cabrati.com.

Faleminderit për mirëkuptim.